



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.138

2 shtator

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.868, datë 18.6.2008	Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore	6123
Vendim i KM nr.1140, datë 30.7.2008	Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit	6124
Vendim i KM nr.1160, datë 13.8.2008	Për miratimin e rregullores “Për etalonet kombëtare të matjes”.....	6146
Vendim i KM nr.1161, datë 13.8.2008	Për miratimin e rregullores “Për shishet enëmatëse”	6149
Vendim i KM nr.1162, datë 13.8.2008	Për njësitë e tjera të matjes jashtë sistemit SI.....	6156

VENDIM
Nr.868, datë 18.6.2008

PËR KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT FIZIK NGA FONDI I TOKËS BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në fondin e kompensimit fizik dhe vënien në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të fondit të tokës bujqësore, me sipërfaqe 17 335 (shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e pesë) ha, të ish-NB-ve dhe institucioneve kërkimore të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sipas dosjeve të dorëzuara nga seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës (SAMT) në qarqe, në zyrat rajonale të AKKP-së, me sipërfaqet e dhëna me hollësi, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave bën verifikimin përfundimtar të pronësisë së truallit për fondin e tokës, të sipërpërmendur, dhe:

a) për sipërfaqet, që përfshihen brenda zonave kadastrale, ku ka përfunduar procesi i regjistrimit fillestar, konfirmimin e bën zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZVRPP);

b) për sipërfaqet, që përfshihen në zonat kadastrale, ku nuk është kryer regjistrimi fillestar, konfirmimin e bën SAMT-ja në qark.

AKKP-ja i përdor sipërfaqet, me statusin e pronësisë shtetërore, për kthimin dhe kompensimin fizik, sipas kriterëve të përcaktuara në ligj.

3. Pas verifikimit përfundimtar, të bërë nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pronat, të cilat rezultojnë me njohje apo kthim pronësie, zbriten nga fondi i mësipërm.

4. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe SMAT-të në qark të bëjnë inventarizimin dhe transferimin e sipërfaqeve të tjera të tokës bujqësore, disponibël shtetërore, të ish-NB-ve, në zyrat rajonale të AKKP-së, sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr.567, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave.

5. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1140, datë 30.7.2008

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE DHE TERRORIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve dhe terrorizmit, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE DHE TERRORIZIMIT

HYRJE

Hartimi i kësaj strategjie është jo vetëm një detyrim që rrjedh nga prioriteti që ka përcaktuar Shqipëria për të luftuar krimin e organizuar dhe gjithë format e shfaqjes së tij, ajo rrjedh nga nevoja e implementimit të detyrimeve që dalin nga strategjia rajonale e miratuar në Brijuni, rrjedh nga nevoja për të harmonizuar e koordinuar më mirë gjithë strategjitë e veçanta të miratuara apo që janë në proces miratimi deri tani.

Kjo strategji merr përsipër të përcaktojë prioritetet strategjike të luftës kundër krimit të organizuar, të përcaktojë objektivat e gjithë institucioneve që marrin detyrime në luftën kundër krimit të organizuar si dhe të harmonizojë veprimet ndërinstytucionale për arritjen e objektivave të përcaktuara. Ajo synon gjithashtu:

- të identifikojë gjerësisht fenomenin e krimit të organizuar dhe fenomenet e tjera pjesë e kësaj strategjie, duke bërë një analizë thelbësore të shkaqeve e faktorëve të zhvillimit;
- të pasqyrojë veprimtarinë institucionale të gjithë aktorëve që marrin detyrime për luftën kundër krimit të organizuar;
- të diagnostifikojë gjendjen në të cilën ndodhet vendi ynë, kryesisht nëpërmjet dokumenteve, medias apo informacioneve të institucioneve ndërkombëtare;
- të përcaktojë prioritetet e objektivat që do të arrihen në minimizimin e krimit të organizuar, duke përmendur format kryesore të shfaqjes së krimit të organizuar;
- të përcaktojë masat që duhet të merren nga institucionet e ndryshme për arritjen e objektivave;
- të përcaktojë rrugët e monitorimit të implementimit të strategjisë.
- të përcaktojë nevojat financiare apo burimet e mundshme financiare për realizimin e aktiviteteve në funksion të implementimit të kësaj strategjie apo strategjive të tjera sektoriale.

Lufta kundër krimit të organizuar nuk duhet parë dhe kuptuar thjesht si përgjegjësi vetëm e policisë së shtetit. Partneriteti midis aktorësh të ndryshëm është element shumë i domosdoshëm i efikasitetit të kësaj lufte. Prandaj dhe strategjia merr përsipër të bëjë ndarjen e detyrave e masave që do të merren nga institucionet e ndryshme. Natyrisht pesha më e madhe e përgjegjësisë dhe e veprimtarisë sinjifikative për treguesit e luftës do t'i mbetet Policisë së Shtetit, e cila duhet të realizojë edhe përqëndrimin e informacionit dhe shpërndarjen e saj sipas objektit të punës së secilit aktor.

Aktualisht, Shqipëria është pjestare në një sërë nismash rajonale e më gjerë si dhe është antare e organizatës SECI, Interpol; gjithashtu ka ratifikuar e nënshkruar një sërë konventash e marrëveshesh ndërkombëtare. Nisur nga sa më sipër dhe nga analiza e faktorëve politiko-socialë, ekonomike, ligjore e teknologjike, si prioritet kryesor të policisë së shtetit në luftë kundër krimit të organizuar do të jenë:

1. Lufta kundër drogave;
2. Lufta kundër trafikëve të paligjshme dhe konkretisht:
 - Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandimit të njerëzve;
 - Lufta kundër trafikimit të armëve;
 - Lufta kundër trafikimit të makinave të vjedhura;
 - Lufta kundër trafikimit të veprave të artit;
 - Lufta kundër pastrimit të parave dhe korrupsionit.
 - Lufta kundër terrorizmit.

Lufta kundër krimit të organizuar mbetet një ndër prioritetet më kryesore të veprimtarisë së institucioneve që kanë detyrime, ashtu dhe Policisë së Shtetit. Kjo e lidhur me vetë pasojat dhe rrezikshmërinë e lartë shoqërore që ka ky fenomen. Krimi i organizuar në vetvete përmbledh shumë aspekte të veprimtarisë kriminale dhe kjo strategji do të bëjë të mundur të vlerësojë situatën, identifikimin e problemeve, si dhe përcaktimin e masave dhe formave të reja që do të përdorin gjithë institucionet kundër këtij fenomeni.

Prioritet e këtij dokumenti u identifikuan duke marrë në konsideratë prioritetet qeverisëse për periudhën 2005-2009, detyrimet që rrjedhin nga strategjia sektoriale 7-vjeçare e Policisë së Shtetit, detyrimet që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Zbatimit të MSA-se dhe Plani i Veprimit për Anëtarësim në NATO, detyrimet e strategjive të tjera që janë në fazën e implementimit dhe që janë hartuar për luftën kundër formave të veçanta të shfaqjes së krimit të organizuar, si ajo kundër drogës, kundër trafikëve të qenieve njerëzore, strategjia antiterror etj., si dhe nisur nga impakti që kanë këto dukuri dhe lufta kundër tyre mbi shoqërinë shqiptare dhe në imazhin e vendit tonë tek partnerët ndërkombëtarë.

Është e rëndësishme që të theksojmë që në pjesën hyrëse të këtij dokumenti, se lufta kundër krimit të organizuar kërkon vizion, përcaktim objektivash dhe burimesh të nevojshme si dhe aftësi për të trajtuar këtë fenomen. Kjo strategji sjell metoda dhe modele të reja në menaxhimin e këtyre burimeve si dhe rritje të aftësive të punojësve të policisë që merren me luftën ndaj këtij fenomeni.

Si konkluzion, ambicia e organizatës së policisë dhe e gjithë institucioneve të tjera që kanë detyrime në këtë drejtim, është dhe do të mbetet, që nëpërmjet implementimit të këtyre objektivave e zbatimit të masave të parashikuara në këtë strategji si dhe në strategjitë e tjera sektoriale, ta bëjë Shqipërinë një vend të sigurt dhe tërheqës, si dhe të përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve. Sigurisht prioritetet dhe objektivat e këtij dokumenti janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga strategjitë egzistuese të cilat janë:

- Strategjia Kombëtare e Luftës kundër drogës 2006-2010;
- Strategjia Kombëtare e Luftës kundër Trafikimit të Fëmijëve 2008-2010;
- Strategjia Kombëtare e Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010.
- Strategjia kundër terrorizmit (e pamiruar akoma);
- Strategjia Ndërsektoriale e Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente, 2007-2013;
- Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Kufijve 2007-2013, miratuar me VKM nr.668, datë 29.9.2007;
- Strategjia Sektoriale e Rendit Publik 2007-2013, miratuar me VKM nr. 14, datë 9.1.2008.

Duke parë hapat e ndërmarra deri tani tani është krijuar besimi i nevojshëm se Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar në forcimin e luftës ndaj fenomenit të krimit të organizuar, duke synuar arritjen e standardeve të kërkuara dhe plotësimin e angazhimeve të marra.

KREU I

1.1 Situata e krimit të organizuar në Shqipëri

Situata e “krimit të organizuar” në Shqipëri kërkon një analizë të veçantë dhe të gjerë, duke mbledhur argumente, fakte e prova për rrugën e zhvillimit dhe format e shfaqjes.

Pas viteve 90’ janë disa faktore që ndikuan në zhvillimin gradual të krimit të organizuar në Shqipëri, fillimisht i shfaqur në forma të thjeshta të grupeve kriminale dhe më pas në grupe të

strukturuara e të organizuara. Faktorët kryesorë që studiuesit renditin për zhvillimin e kësaj forme të ashpër të kriminalitetit janë:

- Vendosja e kontakteve midis elementëve me tendenca kriminale shqiptare me ata të vendeve fqinjë, marrja e eksperiencës së tyre si dhe i formave të zhvillimit të këtij krimi;
- Ndërgjegjësimi i pakët i komunitetit për rrezikshmerinë dhe pasojat e krimit të organizuar;
- Fitimi maksimal i siguruar nëpërmjet krimit të organizuar për një periudhë kohe shumë të shkurtër;
- Nivel i lartë varfërie pothuajse në të gjithë vendin;
- Pozicioni gjeografik i vendit në udhëkryqet midis lindjes e perëndimit;
- Nivel i ulët i reagimit të institucioneve të shtetit, për të përballuar, goditur e ndërprerë lindjen e zhvillimin e formave të krimit të organizuar në Shqipëri;
- Mungesa e instrumenteve ligjorë të nevojshme në luftën kundër krimit të organizuar;
- Rritja e korrupsionit sidomos në strukturat e zbatimit të ligjit, gjykatë, prokurori e polici.

Për shkak të këtyre faktorëve, si dhe të shkaqeve të tjera, brenda një periudhe të shkurtër kohe, Shqipëria filloj të përmendet në raportet e institucioneve ndërkombëtare si një vend burim i një kriminaliteti të lartë. Gradualisht grupet kriminale shqiptare me kalimin e viteve u bënë konkurrentë të grupeve kriminale italiane, franceze, belge, angleze, greke etj.

Krahas lindjes dhe zhvillimit të krimit të organizuar në Shqipëri, lindi edhe reagimi i institucioneve të shtetit dhe kryesisht i organeve të specializuara për t'u vënë në dijeni si dhe goditur raste tipike të disa formave të shfaqjes në krimit të organizuar si-trafikut të lëndëve narkotike, - trafikut të qenieve njerëzore dhe sidomos trafikut të femrave për shfrytëzim për prostitucion, - kontrabandës si dhe veprave të tjera penale të lidhura me trafike të paligjshme.

Ndërkohë janë konstatuar edhe tendenca të krijimit të organizatave kriminale me synime kriminale, të cilat filluan të kryejnë vepra të rënda si vrasje, grabitje me armë, rrëmbime personi, deri në akte terroriste të përdorimit të lëndëve plasëse etj. Organizime kriminale të mirëfillta ishin edhe disa nga firmat piramidale që u krijuan në Shqipëri, me tendencë për pastrim parash apo edhe synime të tjera kriminale.

Për vite të tëra reagimi ndaj një situatë kriminale në rritje ka qenë i dobët, përforcuar dhe nga faktorë të tjerë si presioni, korrupsioni, frika e pasiguria, etj. Ishte presioni i madh nga organizmat ndërkombëtare dhe nga vetë komuniteti që bëri të ndërmarren hapa institucionalë në luftën kundër krimit të organizuar në Shqipëri si dhe disa formave të shfaqjes së tij si – luftës kundër trafikut të njerëzve, femrave apo fëmijëve, luftës kundër trafikut të armëve, luftës kundër trafikut të makinave, trafikut të lëndëve narkotike e kundër kultivimit të bimëve narkotike.

Vetëm në vitet 2005-2007 janë goditur dhe çuar deri në fund disa procese të luftës së krimit të organizuar të cilat kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e besimit dhe opinionit të komunitetit.

Ndikim pozitiv në luftën kundër krimit të organizuar pati edhe fillimi i dënimeve me burgime të rënda i personave të kapur për trafike të paligjshme, e vepra të tjera të rënda të lidhura me krimin e organizuar.

Gjendja pozitive që shfaqet në luftën kundër krimit të organizuar është edhe rrjedhojë e miratimit të instrumenteve ligjorë efikase si dhe aplikimit të eksperiencave më të mira në këtë drejtim, pranimit, ratifikimit dhe implementimit të akteve ndërkombëtare për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Implementimi i ligjit nr.9284 date 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar” bëri të mundur rritjen cilësore të nivelit të identifikimit, hetimit e grumbullimit të provave për goditjen e autorëve që kryejnë vepra penale në lidhje me krimin e organizuar ose forma të shfaqjes së tij, krijoj mundësinë e kryerjes së veprimeve për sekuestrimin e konfiskimin e pasurisë së vënë si rezultat i kryerjes së veprimtarisë kriminale, si dhe krijimit të Komitetit Këshillues për Masat kundër krimit të Organizuar për monitorimin e veprimtarisë të bashkërendimit të punës së institucioneve në zbatim të ligjit, për vlerësimin e ecurisë së administrimit dhe përdorimit të pasurive të sekuestruara e konfiskuara, për dhënien e mendimit për kërkesat për financim të projekteve nga Fondi i Posaçëm për Parandalimin e Kriminalitetit dhe Edukimin Ligjor, si dhe për çështje të tjera që lidhen me parandalimin e goditjen e krimit të organizuar.

1.2 Disa masa të marra për luftën kundër krimit të organizuar

Qeveria në programin e saj përcaktoi si një ndër prioritetet kryesore luftën ndaj Krimit të Organizuar dhe shkatërrimin e organizatave kriminale dhe pjesëmarrjen pa rezerva në luftën globale

kundër terrorizmit përkrah SHBA-së dhe vendeve të tjera perëndimore. Në programin e Qeverisë (2005 – 2009) për Ministrinë e Brendshme theksohet forcimi e garantimi i rendit dhe sigurisë publike, individuale e komunitare si angazhim parësor me moton “Tolerancë zero ndaj krimit”. Lufta kundër krimit të organizuar, trafikeve në përgjithësi dhe qenieve njerëzore në veçanti, si dhe lufta kundër pastrimit të parave do të jetë përparësi. Për këtë qëllim do të bëhen edhe ndryshime ligjore duke parashikuar dënime maksimale dhe nivel të prerë dënimi për këto vepra penale.

Në përmbushje të angazhimeve dhe prioritetëve të qeverisë, brenda kësaj periudhe janë ndërmarrë disa hapa konkrete si:

- Ngritja e Njesisë Antitrafik e cila funksionon në bazë të urdhrit të kryeministrit nr. 203, datë 19.12.2005. Kjo strukturë ka për detyrë kryesore monitorimin e aktiviteteve të institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, bashkërendimin e punës me këto institucione, mbledhjen e informacioneve dhe të dhënave për çështje që lidhen me këtë fenomen etj., është kërkuar nga të gjitha institucionet që janë të përfshira në parandalimin dhe luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore, raportim të masave të realizuara në bazë të planeve të veprimeve dhe më e rëndësishmja propozime për përmirësimin e Strategjisë në përputhje me prioritetet dhe programin e qeverisë, si në hartimin e masave konkrete dhe të prekshme me tregues suksesi ashtu edhe në vendosjen e afateve reale në përmbushjen e tyre.

- U hartua raporti për realizimet, i cili iu shpërnda për informacion të gjitha palëve të interesuara vendase dhe të huaja.

- U ratifikua marrëveshja me Greqinë për mbrojtjen dhe ndihmën e fëmijëve viktimë të trafikut.

Me ligjin nr.9642, datë 20.11.2006 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”” është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”. Gjithashtu, me vendim të Këshillit të Ministrave, u miratua moratoriumi 3-vjeçar për mjetet e lundrimit, me qëllim parandalimin e trafikut nëpërmjet detit. U ngritën Komitetet Antitrafik në nivel lokal, me përfaqësues nga drejtoritë e policive nëpër rrethe, drejtorite arsimore, përfaqësues nga pushteti lokal dhe atyre të shërbimeve sociale. Menaxhimi me i mirë i kufijve dhe aftësimi i seksioneve antitrafik të policisë do t’i shërbejnë gjithashtu këtij qëllimi, për një luftë më efektive ndaj këtij fenomeni. Ndryshime në kuadrin ligjor lidhur me trafikimin si dhe mbrojtja e fëmijëve u përcaktua gjithashtu si një prioritet.

Edhe në fushën e terrorizmit, Shqipëria është një vend aktiv në luftën globale antiterror. Është hartuar një sistem i tërë kombëtar që rregullon strategjinë vepruese ndaj terrorizmit dhe bashkëpunimin ndërmisor në parandalimin dhe goditjen e terrorizmit në mënyrë të vazhdueshme. Qeveria Shqiptare ka hartuar një sërë dokumentesh themelore siç janë: Plani i veprimit në luftën kundër terrorizmit, Ngritja e Komitetit Ndërmisor për Politikën e Sigurisë. Vëmendje i është kushtuar hartimit të kuadrit të duhur ligjor për të mundësuar një bashkëpunim dhe një veprim sa më të koordinuar institucional. Është ngritur Komiteti Ndërmisor për Politikën e Sigurisë, Byroja Koordinative, është hartuar urdhri i përbashkët i Ministrit të Mbrojtjes dhe SHISH-it etj. Shqipëria ka ratifikuar disa nga marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen me luftën kundër terrorizmit, dhe është në bashkëpunim të vazhdueshëm me partnerët ndërkombëtar për shkëmbim informacioni e eksperience në këtë drejtim. Në këtë kuadër parlamenti shqiptar ka ratifikuar një numër ligjesh për të garantuar një bazë sa më të plotë ligjore për përfshirjen e strukturave të FA dhe institucioneve të tjera shtetërore në luftën kundër terrorizmit dhe për të autorizuar mbështetjen e duhur dhe të kërkuar nga organizatat ndërkombëtare siç është NATO, BE etj.

Me këtë kuadër pjesë të veçanta të infrastrukturës sonë kombëtare mund të vihen në dispozicion të operacioneve dhe veprimeve të NATO në kundërshtim të luftës antiterror dhe misionëve të tjera të saj.

1.3 Përcaktimi i krimit të organizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe format e shfaqjes së tij

Në legjislacionin shqiptar, përkatesisht në nenin 28 të Kodit Penal, jepet ky përcaktim për organizatat kriminale:

1. Organizata kriminale është forma më e lartë e bashkëpunimit, në të cilën bëjnë pjesë tre ose më shumë persona dhe që dallohet nga shkalla e veçantë e organizimit, strukturimit, qëndrueshmërisë, kohëzgjatjes, si dhe nga qëllimi për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale.

Organizata kriminale, për realizimin e qëllimeve të saj, përdor forcën, mjetet e tjera të

kërcënimit, nënshtrimit dhe heshtjen për shkak të pjesëmarrjes dhe veprimtarisë së saj, për të kryer vepra penale, për të siguruar, në çdo mënyrë, administrimin ose vënien nën kontroll të veprimtarisë ekonomike, të koncesioneve, autorizimeve, sipërmarrjeve dhe shërbimeve publike, për të realizuar përfitime ose avantazhe të padrejta për vetë a personat e tjerë.

2. Organizata terroriste është formë e veçantë e organizatës kriminale, që synon kryerjen e veprimeve të dhunshme për qëllime terroriste, si përmbysje të rendit kushtetues, turbullim të rëndë të rendit publik, ngjallje të frikës dhe pasigurisë në masë.

3. Banda e armatosur është një formë e veçantë bashkëpunimi që, duke zotëruar armë, municione luftarakë dhe mjete të tjera të nevojshme, synon kryerjen e veprave penale, të parashikuara në krerët V, VI dhe VII të pjesës së posaçme të këtij Kodi.

4. Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale.

5. Krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta.

6. Anëtarët e organizatës kriminale, organizates terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale, të kryera prej tyre, në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale.

7. Pjesëtari i organizatës kriminale, organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal, përfiton përjashtim nga dënimi ose uljen e tij, kur jep ndihmesë, që gjykohet vendimtare për njohjen e veprimtarisë së tyre, të bashkëpunëtorëve të tjerë, pasurive të zotëruara drejtpërdrejtë ose prej tyre, si edhe për veprimtaritë hetimore, që zhvillohen ndaj organizatave kriminale, organizatave terroriste, bandave të armatosura dhe grupeve të strukturuar kriminale*.

Krimi i organizuar është nga veprat penale me të rënda dhe ka format e shfaqjes së tij, të cilat do të jenë objekt i kësaj strategjie, që për efekte të analizimit dhe trajtimit do të merren të shkëputura. Kështu format kryesore të shfaqjes së krimit të organizuar janë:

- Krijimi i organizatave kriminale ose bandat e armatosura;
- Veprat penale në fushën e drogave;
- Veprat penale në fushën e trafikëve të paligjshme, trafikut të personave, trafikut të femrave për prostitucion, trafikut të femijeve, trafikut të mjeteve motorike, trafikut të armeve;
- Veprat penale në fushën e krimeve ekonomiko-financiare;
- Veprat penale në fushën e pastrimit të parave;
- Vepra penale të vrasjes, akteve terroriste ose vrasjeve të cilësuar;
- Veprat penale të korrupsionit;
- Vepra penale të tjera të lidhura me sa sipër.

Këto forma të shfaqjes së krimit të organizuar shpesh ndeshen të ndërthurura në veprimtarinë kriminale të autorëve të tyre, si dhe të shoqëruara edhe me krime të tjera si vrasje, rrëmbime personi, vjedhje me dhunë etj.

Lufta kundër krimit të organizuar mbetet një ndër prioritet me kryesore të veprimtarisë së Policisë së Shtetit si dhe të institucioneve të tjera. Kjo e lidhur me vetë pasojat dhe rrezikshmerinë e lartë shoqërore që ka ky fenomen.

Krimi i organizuar në vetvete përmbledh shumë aspekte të veprimtarisë kriminale dhe ajo që do të mundësojë kjo strategji është vlerësimi i situatës dhe identifikimi i problemeve, si dhe përcaktimi i masave dhe formave të reja që do të përdorin institucionet shqiptare kundër këtij fenomeni.

KREU II

Fushat kryesore të veprimeve të institucioneve të shtetit në luftën kundër krimit të organizuar

Aktualisht, Shqipëria është pjesëtarë në një sërë nismash rajonale e më gjerë si dhe është anëtarë e organizatës SECI, Interpol; gjithashtu ka ratifikuar e nënshkruar një sërë konventash e marrëveshesh ndërkombëtare e angazhime të tjera, për luftën kundër krimit të organizuar.

Nisur nga sa më sipër dhe nga analiza e faktoreve politiko-sociale, ekonomike, ligjore e

* Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr.9275, datë 16.09.2004, neni 2

teknologjike, si prioritete kryesore të institucioneve shtetërore në luftë kundër krimit të organizuar do të jenë:

1. Lufta kundër organizatave kriminale, bandave e grupeve të strukturuar;
2. Lufta kundër drogave;
3. Lufta kundër trafikeve të tjera të paligjshme;
4. Lufta kundër pastrimit të parave dhe korrupsionit;
5. Lufta kundër terrorizmit;
6. Lufta kundër korrupsionit.

Fusha e luftës kundër këtyre fenomeneve (krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme) është një ndër fushat prioritare për Qeverinë Shqiptare si dhe një element shumë i rëndësishëm në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Angazhimet e ndërmarra dhe objektivat e përcaktuara shkojnë në një linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Këto detyrime parashtrojnë domosdoshmërinë e angazhimit të Shqipërisë në nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore, kontrabandën, trafikimin e paligjshëm të armëve dhe të makinave, kontrollin dhe sigurinë e kufijve etj. Këto detyrime përbëjnë një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera, duke kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në stabilitetin rajonal.

Qeveria shqiptare është plotësisht e angazhuar në forcimin e luftës ndaj fenomenit të krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme, duke synuar arritjen e standarteve të kërkuara dhe plotësimin e angazhimeve të marra. Gjithashtu, vendi ynë ka një angazhim të konsiderueshem me forca dhe mjete në luftën kundër terror, në kuadër të operacioneve të NATO-s apo të koalicioneve të veçanta antiterror.

Baza ligjore për luftën kundër krimit të organizuar

Në fushën e krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme ekziston një bazë e gjerë legjislativë, ku si legjislacion parësor mund të përmendet:

- Ligji nr.8920 datë 11.7.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara, kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj; Protokolli i Palermos, i vitit 2000 “Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave veçanërisht të femrave dhe fëmijëve, në plotësim të konventës së OKB-së “Kundër krimit të organizuar ndërkombëtar”.

- Ligji nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

- Ligji nr.8677, datë 2.11.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë Gjyqësore”.

- Ligji nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal”, të cilit në mënyrë të vazhdueshme i janë bërë disa herë ndryshime duke shtuar figura të reja veprash penale kryesisht në fushën e luftës kundër krimit të organizuar.

- Ligji nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të cilit i janë bërë gjatë këtyre viteve një sërë ndryshimesh dhe përmirësimesh në lidhje me procedimin penal të autorëve të krimit dhe aplikimin e teknikave dhe metodave speciale të hetimit.

- Ligji nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

- Ligji nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave” i ndryshuar me ligjin nr.9804 datë 19.6.2003, hartuar në përputhje me standartet e Bashkimit Evropian sipas direktivës 91/308/EC të datës 10.6.1991 “Për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për pastrimin e parave” dhe direktivës 01/97/EC të datës 4.12.2001 e cila amendon direktivën 91/308/EC.

- Ligji nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

- Ligji nr.8722, datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe të lëndëve psikotrope, 1988”.

- Ligji nr.8723, datë 26.12.2000 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën e vetme mbi drogat narkotike”, e ndryshuar nga Protokolli i vitit 1972 “Për ndryshimin e Konventës së Vetme mbi drogat narkotike, 1961”.

- Ligji nr.8965, datë 7.11.2002 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi substancat narkotike e psikotrope, 1971”.

- Ligji nr.8750, datë 26.3.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope”.

- Ligji nr.7975, datë 26.7.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”.

- Ligji nr.8874, datë 29.3.2002 “Për kontrollin e lëndëve që përdoren për fabrikimin e paligjshëm të lëndëve narkotike dhe psikotrope”.

Detyrat kryesore të institucioneve në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit.

- Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit) për organizimin e punës në drejtim të identifikimit të krimit të organizuar dhe goditjes së tij, arrestimit të autoreve dhe hetimit të tyre.

Në këtë institucion janë ngritur struktura speciale të luftës kundër krimit të organizuar në përbërje të Departamentit të Hetimit Kriminal në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me organizim qendror e vendor.

Ndihmëse në këtë drejtim jep edhe Departamenti i Kufirit e Migracionit me masat e marra në drejtim të ruajtjes dhe kontrollit të kufirit, kontrollit e trajtimit të te huajve etj.

Specialistet e këtyre strukturave kanë attribute të grumbullimit të informacionit si dhe attribute të policisë gjyqësore.

- Ministria e Brendshme do të organizojë veprimtarin e strukturave të policisë gjyqësore dhe të thellojë funksionimin e tyre që të jenë në gjendje të vihen në dijeni për tendenca të krimit të organizuar, ta mbajnë nën kontroll atë, të sigurojnë provat e domosdoshme për arrestimin e fajtorëve, si dhe të mbrojnë çështjen deri në dënimin e fajtorit.

- Ministria e Drejtësisë në hartimin e legjislacionit në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe të trafikeve të paligjshme, si dhe në hartimin e politikave të goditjes së ashpër kundër autoreve të krimit të organizuar.

- Prokuroria e Përgjithshme në hetimin e rasteve kriminale të krimit të organizuar dhe zbulimin e plotë të veprimtarisë kriminale të autoreve, dokumentimin ligjor të veprimtarisë së tyre dhe propozimin për sanksione të rënda penale.

- Prokuroria mbikëqyr aplikimin ligjor të metodave e teknikave të reja të investigimit të krimit të organizuar e terrorizmit duke siguruar prova ligjore për veprimtarinë e autorëve të saj.

- Shërbimi Informativ Shtetëror. Veprimtaria e tij përqendrohet në ato objektiva madhorë që vlerësohen ndër prioritetet e politikave shtetërore në rrugën drejt integritetit të plotë evropian të Shqipërisë, veçanërisht në problematikat e përbashkimit me sukses të rreziqeve e kërcënimeve të një luftë asimetrike, e kushtëzuar nga disa mundësi konjukturore të terrorizmit ndërkombëtar, kryesisht të tipit fundamentalist islamik, apo ndaj dukurive të krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, drogës, kontrabandës, korrupsionit, evazionit fiskal, dhe synimeve që prekin integritetin e vendit.

Si institucioni parësor i veprimtarisë së kualifikuar informative në fushën e sigurimit kombëtar, SHISH-i ka forcuar bashkëpunimin me struktura të tjera institucionale, veçanërisht me Ministrinë e Brendshme, jo vetëm në shkëmbim informacioni të klasifikuar, por edhe me investim konkret në operacione e kombinacione operative të përbashkëta.

- Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale, në kuadrin e akomodimit dhe riintegritetit të viktimave të trafikut, të ndjekjes së politikave të rehabilitimit të viktimave.

- Ministria e Transporteve për luftën kundër trafikut të mjeteve motorike e parandalimit të tij, nëpërmjet një sistemi të saktë regjistrimi e kontrolli.

- Ministria e Financave (Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Luftës kundër Pastrimit të Parave, Drejtorinë e Tatimeve).

a) Shërbimi Doganor Shqiptar

Përveç aktiviteteve të saj Shërbimit Doganor Shqiptar ka një mision të rëndësishëm mbrojtës që shtrihet edhe në:

Mbrojtja e sigurisë kombëtare dhe rendit publik, përmes: a). Ndalimit të trafikut të jashtëligjshëm të armëve, eksploziveve, lëndëve helmuese; b) Kontrollit të sigurisë në aeroporte dhe porte, në kuadrin e luftës kundër terrorizmit; Ndalimit të trafikut të narkotikëve dhe substancave psikotrope; c). Kontrollit të parasë "së pisët"; d). Ndalimit të importit, eksportit, tranzitimit të materialeve që rrezikojnë sigurinë kombëtare.

b) Drejtoria e Përgjithshme kundër Pastrimit të Parave me mision “parandalimin e “pastrimit të parave” dhe në luftën kundër financimit të terrorizmit, nëpërmjet grumbullimit, verifikimit, vlerësimit, kontrollit, ruajtjes së informacioneve nga subjektet e ligjit, pezullimit, bllokimit dhe ngrirjes të çdo veprimi me qëllim parandalimin e transferimit, tjetërsimit ose kalimit të pasurisë dhe produkteve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale”

c) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Në kuadrin e strategjisë Ndërsektoriale të Luftës Kundër Krimit të Organizuar, Trafiqeve dhe Terrorizmit administrata Tatimore bashkëpunon me Drejtorinë e Parandalimit të Pastrimit të Parave, me Prokurorinë e përgjithshme si dhe me Policinë e Shtetit.

Qëllimi është identifikimi i rasteve të pastrimit të parave si dhe i krimeve në fushën ekonomike.

- Ministria e Mbrojtjes në grumbullimin e informacionit që ka të bëjë me sigurinë e hapësirës ajrore e detare të RSH, shkëmbimin dhe vënien e tij në dispozicion të strukturave të tjera shtetërore, mbështetjen e strukturave të rendit publik me kapacitete speciale në përballimin e situatave të rënduara publike dhe ato në kufirin shtetëror, kontrollin dhe parandalimin e trafiqeve në hapësirën detare si dhe dhënien e kontributeve reale ushtarake në operacione kundër terror në kuadër të organizmave rajonal dhe ndërkombëtar.

- Ministria e Punëve të Jashtme në drejtim të ndihmesës për bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar, në hartimin e nënshkrimit e marrëveshjeve, traktateve, e akteve të tjera ndërkombëtare etj.

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme në përmbushje të aktmarrëveshjes dypalëshe “Për luftën kundër fenomenit të përdorimit, abuzimit dhe shpërndarjes së drogës në mjediset shkollore”.

- Ministria e Bujqësisë e cila bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme në përmbushje të aktmarrëveshjes dy palëshe “Për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike”.

- Ministria e Shëndetësisë, e cila bashkëpunon me Ministrinë e Brendshme në përmbushje të aktmarrëveshjes dypalëshe “Për forcimin e masave të kontrollit kundër prekursorëve dhe drogave që përdoren në mjekësi”.

KREU III

Identifikimi i formave kryesore të krimit të organizuar e terrorizmit

III. 1. Lufta kundër organizatave kriminale e bandave të armatosura.

Në Shqipëri ka patur tendenca për krijimin e organizatave kriminale e bandave të armatosura, të cilat janë luftuar që në fazen e parë të krijimit të tyre, ose në momentin e identifikimit të tyre.

Grupet e strukturuar kriminale shqiptare kanë patur tipare të organizatave kriminale dhe kanë synuar në përfitime materiale, në kryerjen e veprave penale të ndryshme si trafik droge, trafiqe të tjera të paligjshme si trafik të qënieve njerëzore, armëve, makinave, vrasje, grabitje e vjedhje. Bandat e armatosura u krijuan kryesisht në vitin 1997 dhe vazhduan për disa vjet aktivitetin e tyre kriminal të vjedhjeve, vrasjeve, grabitjeve etj.

Organizatave kriminale, bandat e armatosura, grupet e strukturuar kriminale apo grupet e tjera kriminale do të trajtohen në strategji sipas drejtimeve të zhvillimit të veprimtarisë kriminale, ose sipas tendencës kryesore kriminale që ato kryejnë.

Grupet kriminale shqiptare janë përfshirë në trafikun ndërkombëtar të drogës, duke u bërë pjesë e rrjeteve të këtij trafiku, janë përfshirë në trafikun e qënieve njerëzore, veçanërisht në trafikun e femrave për prostitucion, në trafikun e armëve kryesisht me vendet fqinje si dhe në trafiqe të tjera të paligjshme.

Në luftën kundër organizatave kriminale e bandave të armatosura, përveç strukturave të prokurorisë e policisë së shtetit, detyrime të veçanta kanë edhe institucionet e tjera, si strukturat e sistemit gjyqësor, shërbimet informative si: Shërbimi Informativ Kombëtar, Shërbimi Informativ i Ushtrisë etj.

III. 2. Lufta kundër trafikut të drogës

Pozita e përshtatshme gjeografike e vendit tonë ka ndikim në fenomenin e trafikut të drogës. Grupet kriminale të përfshira në trafikimin e lëndëve narkotike e përdorin territorin shqiptar si vend

tranzit për kalimin e drogave të forta, kryesisht heroinë, me destinacion vendet perëndimore. Një pjesë e kësaj sasive mbetet në vendin tonë me qëllim plotësimin e nevojave të brendshme e cila lidhet me numrin gjithnjë e më rritje të përdoruesve të drogave.

Vendi ynë ende mbetet në listën e vendeve që kultivojnë *canabis sativa* edhe pse si pasojë e operacioneve të viteve të fundit është reduktuar ky fenomen, ende ekzistojnë zona të vecanta ku konstatohen raste të kultivimit të *canabis sativa*.

Pavarësisht eksperiencës së re, rezultatet e viteve të fundit kanë treguar sukses të policisë së shtetit ndaj këtij fenomeni. Sasitë e drogave që trafikohen drejt vendeve të destinacionit kanë ardhur në rënie konstante. Këto rezultate kanë lidhje me plotësimin pothuajse të plotë të legjislacionit në këtë fushë, përdorimin e formave dhe metodave të vecanta të hetimit, si dhe në rritjen e kapaciteteve të njësive të specializuara që merren me luftën kundër drogës.

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e luftës kundër trafikimit të drogës, si dhe implementimit të strategjise antidroge e kësaj strategjie, përveç atyre të përmendura në kreun e II, janë përgjegjëse këto struktura e institucione:

Spektori i Luftës Kundër Drogës (Shërbimi Qendror i Luftës kundër Drogës), në Ministrinë e Brendshme, i cili përbën organin e vetëm përgjegjës për trajtimin në mënyrë të unifikuar të veprimtarisë së strukturave të policisë për veprat penale në fushën e drogës. Misioni i këtij sektori qendror është:

- kryerja e veprimtarisë koordinuese, bashkëvepruese, operacionale, administrative, hetimore për veprat penale në fushën e drogës dhe ato që i delegohen nga prokuroria në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe detyra të tjera që i ngarkohen nga Kodi Penal dhe legjislacioni aktual në këtë fushë;

- bashkërendimi dhe koordinimi i veprimtarisë që buron nga bashkëpunimi policor ndërkombëtar dhe organizma të tjera ndërkombëtare që trajtojnë problemet e drogës;

- koordinimi i veprimtarisë operacionale midis Seksioneve të Luftës Kundër Drogës (zyrave rajonale) dhe strukturave të tjera që merren me luftën kundër krimit.

Institucione të tjera përgjegjëse për luftën kundër drogës, përveç atyre të përmendura në kreun e II janë edhe:

Qendra Kombëtare për kontrollin mbi drogën, e cila është përgjegjëse për analizat dhe mbikëqyrjen administrative në lidhje me kontrollin e drogave që përdoren në mënyrë të ligjshme.

Departamenti farmaceutik, i cili është përgjegjës për zbatimin e ligjit lidhur me:

monitorimin e aktiviteteve farmaceutike nëpërmjet Shërbimit të inspektimit farmaceutik.

Instituti i Shëndetit Publik, i cili monitoron praktikën lidhur me përshkrimet e recetave dhe përgatit udhëzues për përshkrimin e ilaçeve me përmbajtje narkotike.

III. 3. Lufta kundër trafikëve të tjera të paligjshme

Fenomeni më i përhapur i trafikëve të paligjshme ka qënë ai i trafikimit të qënieve njerëzore, ku si rezultat i hartimit të një strategjie të vecantë për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, angazhimit dhe mbështetjes së dhënë (një sërë iniciativash për krijimin e komiteteve dhe grupeve të përbashkëta për të luftuar këtë fenomen) janë arritur suksese të konsiderueshme. Nisur nga ky sukses mund të pranojmë se Shqipëria nuk konsiderohet me një vend tranzitimi i qënieve njerëzore. Aktualisht në jemi një vend destinacioni i trafikut të makinave të vjedhura. Përsa i përket trafikut të armëve dhe municioneve luftarake në mbetimi vend i origjinës dhe i tranzitimit.

Si rrjedhojë e përdorimit të formave dhe metodave të vecanta të hetimit, suksese janë arritur dhe në luftën kundër trafikëve të tjera të paligjshme.

Me përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Punëve të Jashtme, në Maj të vitit 2006 është ngritur Autoriteti Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar Referues të rasteve të viktimave të trafikut për të bashkërenduar procesin e referimit, dhënies së mbrojtjes fillestare dhe rehabilitimit afatgjatë të viktimave të trafikut, në bashkëpunim të ngushtë me shërbimin social shtetëror, përfaqësitë shqiptare diplomatike jashtë vendit dhe me qendrat e specializuara për strehimin e viktimave të trafikut në vend.

Janë ngritur Komitete Rajonale Antitrafik, me urdhër të Kryeministrit nr.139, datë 19.6.2006 “Për krijimin e komiteteve rajonale të luftës kundër trafikut të qënieve njerëzore“. Këto komitete luajnë një rol të rëndësishëm në trajtimin e rasteve të identifikuar si viktimë apo viktimave potenciale të trafikut.

III. 4 . Parandalimi i pastrimit të parave

Në drejtimin e parandalimit të pastrimit të parave synohet forcimi i luftës kundër pastrimit të parave me origjinë nga trafiqet ilegale dhe terrorizmi si dhe për dekriminalizimin e aktivitetit ekonomik në vend. Në këtë mënyrë synohet që t'i shërbehet rritjes së besueshmërisë në vend dhe në sistemin e tij ekonomik e ligjor.

Për realizimin e këtij synimi kërkohet bashkëpunim i mire brenda vendit midis agjencive që punojnë në këtë drejtim si dhe me vendet e tjera me qëllim parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe përdorimin e tyre për qëllime të financimit të terrorizmit. Bashkëpunimi në këtë fushë do të mbështetet në zbatimin e standardeve dhe mekanizmave të përshtatshëm, për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në standartet e Bashkimit Evropian dhe instrumentave të tjerë ndërkombëtare në këtë fushë.

Kuadri institucional ekzistues

Për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi në fushën e parandalimit të pastrimit të parave janë përgjegjëse këto struktura:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), e cila është në rolin e njësisë së inteligjencës financiare.

b) Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP). Ky komitet drejtohet nga Kryeministri dhe në përbërje ka Ministrin e Financave, Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Drejtorin e SHISH-it dhe Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKP-së.

c) Drejtoria e Krimeve Ekonomiko-Financiare dhe Drejtoria e Luftës Kundër Krimin të Organizuar pranë Departamentit të Hetimit Kriminal, në Ministrinë e Brendshme.

a) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), e cila është në rolin e njësisë së inteligjencës financiare. Misioni i kësaj Drejtorie konsiston në:

- Parandalimin e “pastrimit të parave” dhe në luftën kundër financimit të terrorizmit, nëpërmjet grumbullimit, verifikimit, vlerësimit, kontrollit, ruajtjes së informacioneve nga subjektet e ligjit, pezullimit, bllokimit dhe ngrirjes të çdo veprimi me qëllim parandalimin e transferimit, tjetërsimit ose kalimit të pasurisë dhe produkteve që rrjedhin nga veprimtaria kriminale;

- Bashkërendimin me struktura të tjera të zbatimit të ligjit të tilla si Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi Informativ Kombëtar dhe me Organizma homologe dhe Institucione ndërkombëtare.

- Hartimin e programeve të bashkëpunimit dhe asistencave të ndërsjellta në drejtim të parandalimit të “pastrimit të parave” me vende të ndryshme, në bazë të konventave ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara.

b) Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave (KBLKPP). Komiteti i Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave është përgjegjës për përcaktimin e drejtimeve të politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Komiteti drejtohet nga Kryeministri dhe në përbërje ka Ministrin e Financave, Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Drejtorin e SHISH-it dhe Inspektorin e Përgjithshëm të ILDKP-se. Komiteti mblidhet të paktën një herë në vit për të shqyrtuar dhe analizuar raportet për veprimtaritë e kryera nga autoriteti përgjegjës, si dhe raportet për dokumentat e përgatitura nga institucionet dhe organizmat ndërkombëtare, të cilat ushtrojnë veprimtaritë e tyre në fushën e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Përgjegjës i ofron komitetit, sipas kërkesës së tij dhe vepron si këshilltar në mbledhjet e këtij komiteti.

Në mbledhjen e komitetit mund të ftohen për të marre pjesë ministra, deputetë, drejtues ose përfaqësues të institucioneve dhe ekspertë në fushën e parandalimit dhe luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Komiteti mund të krijojë grupe pune teknike dhe/ose operacionale për të ndihmuar në kryerjen e funksioneve që ka, si dhe për studimin e tipologjive dhe të teknikave të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Rregullat e funksionimit të komitetit përcaktohen në rregulloren e brendshme, të miratuar nga

ky komitet.

c) Sektori i Luftës Kundër Pastrimit të Parave në Drejtorinë e Luftës Kundër Krimin të Organizuar të Departamentit të Hetimit Kriminal, në Ministrinë e Brendshme. Detyra e këtij sektori është drejtimi, bashkërendimi, kontrolli dhe ushtrimi i veprimtarisë për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe ndërprerjen e aktivitetit kriminal në fushën e pastrimit të parave dhe krimeve në fushën ekonomike dhe financiare.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ushtron veprimtarinë e saj me qëllim parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit e krimin financiar, në përgjithësi.

E strukturuar në dy drejtori, Drejtoria e Analizës dhe Monitorimit dhe Drejtoria e Parandalimit dhe Mbikëqyrjes, DPPP kryen funksionet e njësisë së informacionit financiar. Ajo shërben si qendër kombëtare dhe është përgjegjëse për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen autoriteteve kompetente të të dhënave për dyshime për pastrim parash dhe financim të mundshëm të terrorizmit. të dhënat mbledhen nga informacioni financiar i raportuar nga subjektet e parashikuara në ligjin nr.9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”.

Raportimi ka të bëjë me: rastet e transaksioneve financiare mbi vlerën e parashikuar në ligj, rastet e dyshimit të detektuara nga subjektet raportuese, si dhe deklaratimet e kalimit të “cash” brenda dhe jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.

Në vitin 2002 u nënshkrua MOU ndër-institucional ndërmjet Ministrisë së Financave, BSH, SHISH, Prokurorisë dhe Ministrisë së Brendshme. për të realizuar detyrimet e percaktuara nga institucionet që nënshkruan këtë memorandum dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara, si dhe për të bërë të mundur: identifikimin, zbulimin, ngrirjen, bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e parave, pasurive, të ardhurave e fitimeve ose produkteve të rrjedhura nga veprimtaria kriminale e kryesisht nga krimi i organizuar si dhe për penalizimin e anëtarëve të kësaj veprimtarie dhe parandalimin e këtij fenomeni u vendos të krijohet Grupi i Kontaktit në përbërje të te cilit ka specialistë nga këto institucione. Ky grup përbëhet nga: Drejtori i Përgjithshëm i DPPP-se në rolin e Kryetarit të këtij Grupi; Perfaqësues i Ministrisë së Brendshme (anëtar); Perfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme(anëtar); Perfaqësues i Sherbimit Informativ Shtetëror (anëtar); Perfaqësues i Bankës së Shqipërisë (anëtar).

Sektorët përberës të këtyre institucioneve që ndjekin krimin ekonomiko-financiar, parashikojnë format e bashkëpunimit për të operuar sipas kërkesave të ligjit për shkëmbim informacioni, për individët, persona fizikë dhe juridikë, për të cilët dyshohet se origjina e pasurisë së tyre mund të jetë rrjedhojë e një veprimtarie kriminale; parashikojnë detyra për marrjen e informacioneve në pikat e kalimit kufitar për rastet e nxjerrjes jashtë ose hyrjen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë se vlerës cash ose ceqe udhëtar; në varesi të situatave që krijohen, sipas problemeve konkrete parashikojnë detyra për vlerësimin, domosdoshmerinë dhe rëndësinë e bashkëpunimit në shkëmbimin e informacioneve; bashkëpunojnë për zbulimin, dokumentimin dhe identifikimin e pasurive që rrjedhin nga veprimtaritë kriminale të organizuara sic janë: trafiku i qenieve humane, trafiku i drogës, trafiku i armeve, kontrabanda, evazioni fiskal etj. Grupi i Punës mbledhet jo më pak se një herë në muaj për përgatitjen dhe marrjen e detyrave të përbashkëta, si dhe jo më pak se një herë në tre muaj në prani të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve nënshkruar të këtij memorandum. Rezultatet e punës i behen të njohura Qeverisë. Anëtarët e Grupit të Punës mbajnë lidhje të vazhdueshme me titullaret e tyre duke u raportuar arritjet dhe problemet gjatë ushtrimit të detyrës.

Një ndihmese të konsiderueshme DPPP jep në formalizimin e ekonomisë. Shumica e deklaratimeve dhe raportimeve që bankat dhe institucionet financiare e jo financiare bëjnë ndihmojnë në këtë drejtim.

Në kuadrin e bashkëpunimit ndër-institucional janë nënshkruar MoU me ILDKP dhe me Zyren e Antikorrupsionit dhe Kontrollit të Brendshëm në Keshillin e Ministrave.

Shqipëria është anëtare me të drejta të plota në Grupin Egmont që prej vitit 2005 dhe përfaqësohet prane tij nga Drejtori i Përgjithshëm i DPPP-se. Drejtori i Përgjithshëm i DPPP-se është gjithashtu kryetari i delegacionit të përhershëm prane Moneyval, në përberje të te cilit janë edhe një përfaqësues nga Ministria e Brendshme dhe një nga Ministria e Drejtësisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave përgjigjet për bashkëpunimin dhe bashkërendimin ndërkombëtar të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në

përputhje me standartet ndërkombëtare të përcaktuara nga Grupi ndërkombëtar kundër zbardhjes së kapitaleve GAFI-FATF, direktivat nr. 308, e vitit 1991, dhe nr. 97, e vitit 2001, direktiva e III-të e vitit 2005/60 e Bashkimit Evropian, konventat e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (Konventa e Palermos), dhe kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike e lëndëve psikotrope (Konventa e Vjenës, e vitit 1988), Konventa e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të terrorizmit, e vitit 1999, si dhe rezolutat e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara.

Serioziteti dhe angazhimi i qeverisë Shqiptare në luftën kundër financimit të terrorizmit, është konkretizuar jo vetëm në hartimin e akteve nenligjore në zbatim të ligjit nr.9258, date 15.7.2004 për “Masat e luftes kundër financimit të terrorizmit”, VKM nr.718, dhe VKM nr.767, date 14.11.2007 për “Listen e shpallur të financuesve të terrorizmit”, por edhe në parashikimin për here të pare në ligjin e ri nr. 9917, date 19.5.2008” “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” të masave parandaluese të financimit të aktiviteteve të mundshme terroriste.

Në muajin maj 2007 Ministri i Brendshëm, Ministri i Financave, Prokurori i Përgjithshëm si dhe Drejtori i Sherbimit Informativ Kombëtar nënshkruan një memorandum bashkëpunimi për njesinë e perbashket investigative në luftë kundër krimit të organizuar “Memorandum i Bashkëpunimit për Ngritjen e Njesisë së Perbashket Hetuese për Krimin Ekonomik dhe Korrupsionin”^{*} duke bërë të mundur sigurimin e bashkëpunimit midis këtyre agjencive me krijimin e një task-force të perbashket.

III. 5. Ruajtja e kufirit shtetëror

Menaxhimi dhe siguria në kufi, janë prioritet i Qeverisë Shqiptare, si në raport me detyrimet ligjore, politike dhe sigurinë kombëtare brenda vendit, ashtu edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare veçanërisht në procesin e anëtarësimit në strukturat euroatlantike, për ndërtimin e besimit me shtetet fqinje dhe më gjerë, si dhe për të kontribuar në luftën kundër krimit të organizuar.

Institucionalisht Policia Kufitare dhe e Migracionit ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të kufirit, kontrollin e qarkullimit të njerezve, mjeteve dhe mallrave nepermjet kufirit shtetëror.

Kjo strategji i krijon hapësirën e nevojshme Strategjise së Menaxhimit të Integruar të Kufijve si dhe Planit të Veprimit të saj, për të thelluar masat në drejtim të rritjes së standardeve të kontrollit të kufijve, hyrjeve e daljeve, pengimit të realizimit të krimeve nepermjet kufirit dhe në veçanti krimit të organizuar e terrorizmit.

III. 6. Lufta kundër akteve terroriste

Shqipëria bën pjesë në vendet që kryejnë një luftë aktive kundër terrorizmit, duke e vlerësuar si një rrezik serioz për popujt.

Fakti që në Shqipëri nuk ka raste të terrorizmit apo të rrezikut për terrorizëm lidhet edhe me karakterin human të popullit shqiptar, lidhet me faktin se ky popull dëshiron të jetojë në paqe dhe harmoni me popujt e tjerë.

Situata në Shqipëri është e qetë dhe me masa të plota në drejtim të parandalimit të akteve të mundshme terroriste, si të drejtuara kundër vendit tonë ashtu dhe ndaj vendeve të tjera.

Eksistenca e krimit të organizuar si dhe i mundësive për të ardhur financime për terrorizëm të mundshëm, kërkon rivlerësimin e përhershëm dhe një gatishmëri të lartë në drejtim të gjetjes së burimeve të informacionit, bashkëpunimit të ngushtë midis institucioneve shtetërore që marrin angazhime në këtë drejtim si dhe marrjes së masave me karakter parandalues.

Në kuader të zbatimit të “Planit Kombëtar të Veprimit kundër Terrorizmit”, miratuar me VKM nr. 12, datë 28.1.2002, të gjitha institucionet shtetërore kanë detyrimet e tyre në luftën kundër terrorizmit.

Kështu, krahas Drejtorisë së Antiterrorit dhe Krimeve të Renda, në Departamentin e Hetimit Kriminal të Policisë së Shtetit, detyrime të veçanta në luftën kundër terrorizmit kanë edhe Shërbimi Informativ Shtetëror, Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave, si dhe Prokuroria.

Në kuader të bashkëpunimit mes strukturave qeveritare, funksionon Komiteti Nderministror për fushat e kriminalitetit, ku aktivizohen edhe OJQ të ndryshme.

III.7 Lufta kundër korrupsionit

Lufta kundër krimit të organizuar është pare e lidhur ngushtë me luftën kundër korrupsionit, sepse pa eliminuar atë nuk mund të kemi sukses në këtë luftë.

^{*} Memorandum of Cooperation establishing the Economic Crimes and Corruption Joint Investigative Unit.

Qeveria Shqiptare ka vlerësuar se lufta kundër elementeve të korruptuar është një prioritet i saj dhe ka marre një sere masash për uljen e nivelit të korrupsionit. Kështu, ajo ka hartuar një strategji të veçantë të luftes kundër korrupsionit duke synuar që në një periudhë të shkurtër kohore të minimizojë korrupsionin në institucionet shtetërore.

Rritja e korrupsionit në përmasa tepër të rrezikshme, rënia e tregjeve nën kontrollin e monopoleve, zbatimi i dobët e i shtrembëruar i ligjit, vonesat në kryerjen e reformave kanë shkaktuar humbjen në shkallë të gjerë dhe në nivele tepër të larta të besimit të shqiptarëve të institucionet shtetërore. Raportet e ndryshme ndërkombëtare, por edhe studimet e sondazhet e ndryshme të kryera, si dhe konstatimet e aktorëve të ndryshëm qeveritarë e joqeveritarë, kanë theksuar, ndër të tjera:

- zbatimin e dobët të kuadrit ligjor antikorrupsion ekzistues.
- zbatimin e dobët të instrumenteve administrative për të parandaluar korrupsionin (administrata publike, transparencë e dobët, keqfunksionimi i sistemit të kontrollit, etj.);
- bashkërendimin e pamjaftueshëm ndërmjet strukturave të kontrollit/auditit dhe të ndjekjes penale që luajnë rol në fushën e luftës kundër korrupsionit;
- mosfunksionimin e institucioneve që kanë përgjegjësi ligjore në luftën kundër korrupsionit.

Në rastin e sistemit të drejtësisë, disa nga problemet më shqetësuese lidhen me transparencën e ulët të proceseve penale dhe civile të drejtësisë, çka ka sjellë shkallë të ulët besueshmërie të publikut të sistemi gjyqësor; mungesën e transparencës dhe procedurat jo objektive të emërimit të gjyqtarëve e prokurorëve; mangësitë në statusin, pavarësinë dhe mbrojtjen e posaçme që u sigurohet gjyqtarëve; mangësitë infrastrukturore në gjykata, prokurori, burgje, dhoma paraburgimi, etj.; mungesën e statusit dhe pagat e ulëta të personelit administrativ të gjykatave; dhe shkallë jo të kënaqshme të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Sistemi i prokurimeve publike shpesh nuk i ka shërbyer qëllimit të përdorimit të fondeve publike në mënyrë efikase. Vlerësimi i ofertave është i dobët dhe mbikëqyrja e pamjaftueshme. Përqindja e kontratave të realizuara në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jokonkuruese ka qenë e lartë. Ligji i ri për prokurimet publike parashtron parimet kryesore, siç janë: respektimi i procesit, dhënia e informacionit dhe transparencë.

Lufta kundër korrupsionit synon jo vetëm në identifikimin e goditjen e rasteve të korrupsionit, por edhe në eliminimin e faktoreve e shkaqeve që zhvillojnë atë, në eliminimin e korrupsionit si fenomen, e për rrjedhojë rritjen e cilësisë së luftes kundër krimit të organizuar.

Lufta kundër korrupsionit kërkon marrjen e masave ligjore, strukturore, administrative e koordinuese, kërkon një ndërgjegjesim me të madhe të komunitetit dhe goditje të ashpër të elementeve korruptive. Pikerisht, Strategjia e Luftes kundër Korrupsionit ka parashikuar një sere veprimesh e masash, të cilat do të bejnë të mundur rritjen e luftes në këtë drejtim, e për pasojë minimizimin e tij.

Në këtë strategji synohet që masat e parashikuara në Strategjinë kundër Korrupsionit të thellohen në drejtim të objektivave e prioritetëve duke bërë të mundur përshpejtimin e masave për arritjen e qëllimit.

Puna e filluar sidomos në vitin 2007, tregon një rritje cilësore të goditjes së korrupsionit, tregon se kur ka angazhim serioz e koordinim të mirë midis institucioneve që luftojnë korrupsionin, efektet pozitive janë të ndjeshme si në treguesit statistikore, ashtu dhe në reagimin e komunitetit kundërshtues këtij fenomeni.

III.8 Mbrojtja e bashkepunetoreve

Lufta kundër krimit të organizuar, trafikëve, korrupsionit e terrorizmit është e lidhur dhe me marrjen e masave për mbrojtjen e deshmatareve e bashkepunetoreve të drejtësisë. Për këtë qëllim Qeveria Shqiptare ka marre një sere masash për realizimin e kësaj mbrojtje e çuarjen deri në fund të hetimeve kundër grupeve të rrezikshme kriminale.

Duke e vlerësuar si një prioritet që ndikon direkt në rritjen e efektivitetit të punës për luftën kundër krimit të organizuar, mbrojtja e deshmatareve ka ardhur duke u rritur e realizuar cilësisht. Kështu, është ngritur në nivel drejtorie sektori që realizon mbrojtjen e deshmatareve, si dhe është fuqizuar me burime financiare e materiale. Janë hartuar aktet e nevojshme ligjore si dhe është ngritur një grup pune për ripunimin e ligjit sipas standardeve të vendeve të BE-së.

Në të gjitha rastet e paraqitura në dy vitet e fundit, kërkesat për mbrojtje të veçantë, janë realizuar duke dhënë një kontribut të ndjeshëm në hetimin e grupeve kriminale, si dhe duke bërë të mundur eliminimin e kercenimeve e kanosjeve që u janë bërë personave që kanë pranuar marrjen në mbrojtje.

Ripunimi i ligjit dhe rritja e bashkëpunimit nderkombetar në drejtim të sigurimit të mbrojtjes se deshimtareve e bashkepuntoreve të drejtesise do të beje të mundur rritjen e efektivitetit të luftës kundër krimit të organizuar në Shqipëri.

KREU IV

Vizioni

Synimi strategjik afatgjate i implementimit të kësaj strategjie është “ ndertimi i një shoqerie, pa kercenime nga krimi i organizuar, në paqe dhe në permiresim të vazhdushem të cilesise se jetes se qytetareve, duke dhënë në kete mënyrë imazhin e një vendi të qetë e në standarte të larta të sigurise”.

Ky vizion është i lidhur ngushtësisht me përcaktimin e pergjegjesive të çdo institucioni, ndertimin e infrastruktures se plote ligjore, rritjen e kapaciteteve e aftësive tekniko-profesionale, zbatimin cilësor të masave e detyrave të parashikuara në planet e veprimit të strategjive të tjera të lidhura me te, rritjen e bashkëpunimit nder institucional dhe implementimin sipas fazave të kësaj strategjie.

Me implementimin e strategjise synohet qe në vitin 2013 të kemi një vend ku janë shkatërruar grupet kriminale, ku është minimizuar në maksimum krimi i organizuar, ku kriminaliteti nuk është shqetësim me për komunitetin dhe të kemi standarde të larta të sigurise, të jemi një vend ku ligji zbatohet rigorozisht dhe respektohen lirate dhe të drejtat e njeriut.

KREU V

Politikat e objektivat në luftë kundër krimit të organizuar e terrorizmit

V. 1 Për drejtimin e luftes kundër krimit të organizuar

Fusha e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikeve të paligjshme është një ndër fushat prioritare për Qeverinë Shqiptare si dhe një element shumë i rëndësishëm në kuadër të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Nga ana e BE kerkohet angazhimi i Shqipërisë në nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë për zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, për çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar, migrimit të paligjshëm dhe trafikimit, duke përfshirë në veçanti atë të qenieve njerëzore, kontrabandën, trafikimin e paligjshëm të armëve dhe të makinave, etj.

- Kryerja e hetimeve me qëllim shkatërrimin e plote të rrjeteve kriminale, organizateve kriminale apo grupeve të strukturuar, për të gjitha tendencat apo format e krimit.

- Partneriteti si një nder politikat kryesore të ketyre strukturave.

- Identifikimi i eksperinca e vendeve me të perparuara në luftë kundër krimit të organizuar.

- Rritja e riskut për personat apo grup personash të perfshire në keto aktivitete.

- Te zvogeloje oferten dhe destabilizojte tregun e drogave duke minimizuar perdorimin e saj.

- Eliminimi i rasteve të korrupsionit e krimeve në fushën ekonomiko financiare.

- Sensibilizim në rritje të qytetareve në lidhje me efektet e krimit të organizuar në shoqerine shqiptare e në destabilizimin e ekonomise se vendit.

- Minimizim i trafikut të qenieve njerezore e trafikeve të tjera.

- Realizim i parandalimit të pastrimit të parave në vend.

V.2 Për luftën kundër drogës

Qeveria Shqiptare, në përputhje me Strategjinë AntiDrogë, synon që:

- të krijojë një sistem efikas të vlerësimit të rrezikut, që lidhet me ofertën për drogë, konsumin dhe efikasitetin e veprimtarive antidrogë;

- të forcojë e të përmirësojë aksionet kundër trafikimit të drogave ilegale dhe prekusorëve si një pjesë integrale e luftës kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave dhe korrupsionit,

- të përmirësojë ndërveprimin dhe bashkërendimin ndërmjet institucioneve shtetërore dhe jo

shtetërore të angazhuara në luftën kundër drogave;

- të kontrollojë pasojat negative mbi shëndetin publik dhe mbi shoqërinë nga përdorimi i drogës, të forcojë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe vendet e tjera.

Politikat e drogës dhe veprimet do të përdoren për reduktimin e ofertës, trafikimin dhe kërkesën për drogat e paligjshme, si dhe për të ushtruar një kontroll më të efektshëm të shkelësve. Veprimet në këtë fushë do të bazohen në principe të rëna dakort sipas parimeve të Strategjisë Europiane për Drogën si dhe Koventave dhe instrumentave të tjera ndërkombëtare në këtë fushë.

V.3 Lufta kundër trafikeve të tjera të paligjshme

Lufta kundër trafikeve të paligjshme bazohet në strategjite kundër trafikut të qenieve njerëzore dhe atë të luftes kundër trafikut të fëmijëve, si dhe në planet e veprimit perkatese për çdo formë të trafikut të paligjshëm. Implementimi i Strategjisë së Luftes kundër Krimin të Organizuar do të thellojë masat në drejtim të goditjes e parandalimit të këtyre trafikeve.

Drejtimet kryesore ku do të përqendrohet lufta kundër trafikeve të paligjshme janë:

- Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore;
- Lufta kundër trafikut të armëve dhe municioneve;
- Lufta kundër trafikut të mjeteve motorrike;
- Lufta kundër trafikut të veprave të artit;
- Parandalimi dhe minimizimi i kontrabandimit të personave

V. 4 Për parandalimin e pastrimit të parave

Parandalimi i pastrimit të parave do të sjellë rënien e krimin të organizuar, dekriminalizimin e aktivitetit ekonomik në vend dhe është prioritet i Qeverisë Shqiptare.

Në këtë synim Qeveria Shqiptare do të bashkëpunojë me vendet e tjera me qëllim parandalimin e përdorimit të sistemeve të tyre financiare për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe përdorimin e tyre për qëllime të financimit të terrorizmit.

Bashkëpunimi në këtë fushë do të mbështetet në zbatimin e standarteve dhe mekanizmave të përshtatshme, për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në standartet e Bashkimit Evropian dhe instrumentave të tjerë ndërkombëtare në këtë fushë.

- Zbatimi dhe implementimi i ligjit të ri nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, si dhe rritja e numrit të raporteve (RTV dhe RAD) të marra, deri në masën 100.000 brenda vitit 2008; rritja e numrit të inspektimeve deri në 130 brenda vitit 2008.

- Zbatimi i politikave dhe strategjive kombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftes kundër financimit të terrorizmit.

- Dizenjimi i një platforme IT të plotë dhe eficientë për të ndihmuar në thithjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit financiar: përpunimi eficient i informacionit financiar të marre nepermjet RTV e RAD me qëllim hartimin dhe përpilimin e dosjeve të plota për tu referuar në Prokurorinë e Përgjithshme për ndjekje penale.

- Rritja e efikasitetit në punë dhe shtimi i rasteve të parandaluara të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

V. 5 Për ruajtjen e kufijve e migracioni

Menaxhimi dhe siguria në kufi, përbën një angazhim të Qeverisë Shqiptare si në raport me detyrimet ligjore, politike dhe sigurinë kombëtare brenda vendit, ashtu edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare veçanërisht në procesin e anëtarësimit në strukturat euroatlantike, për ndërtimin e besimit me shtetet fqinje dhe më gjerë, si dhe për të kontribuar në luftën kundër krimin të organizuar.

Politika për realizimin e kufijve të hapur, por në të njëjtën kohë të kontrolluar dhe të sigurte kërkon menaxhimi eficient i kufirit duke u angazhuar të punojë së bashku me vendet e rajonit për të arritur atë në shkallë rajonale.

- Adoptimi i standardeve të larta të kontrollit në kufi si dhe kontrollit të te huajve.
- Përafrimi i legjisllacionit kombëtar për kufirin me standartet e vendeve të BE.
- Partneriteti me strukturat që operojnë në kufi si dhe me strukturat homologe të vendeve fqinje.

- Implementimi i strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit.
- Politike efikase ndaj shtetasve të huaj brenda vendit dhe luftë kundër terrorizmit e krimin të organizuar, që mund të kryhet nepermjet kufirit.

Forcimi i kontrollit të kufijve për të parandaluar aktivitetet kriminale si dhe çdo aktivitet tjetër

që mund të vërë në rrezik sigurinë e vendit është synim i strukturave që operojnë në kufi dhe që do të realizohet me implementimin e Strategjise së Menaxhimit të Integruar të Kufirit. Këto kontrole do të synojnë të:

- Pengojnë kriminelët të kryejnë aktivitete ilegale ndërkufitare, duke parandaluar ose duke zbuluar aktivitetet e tyre.

- lufta ndaj trafikeve të të gjitha llojeve, imigracionit të paligjshëm, terrorizmi dhe krimi i organizuar, do të jenë në fokusin e strukturave që merren me kontrollin e kufirit.

- Kontrolli i “dyerve” konsiderohet mjaft i dobishëm dhe eficient për parandalimin e zhvillimit dhe përhapjes së krimit, ndëshkimin e kriminelëve dhe pakësimin e përfitimeve të tyre të paligjshme.

Institucionet kombëtare (sidomos doganat, policia kufitare, autoritetet fito-sanitare, etj) nepermjet implementimit të ketyre strategjive do të forcojnë bashkëpunimin ndër-institucional, për t'i bërë pikat e kalimit të kufirit më efiente, si për sa i përket flukseve të mallrave dhe personave, ashtu edhe për sa i përket kontrollit të aktiviteteve kriminale ndërkufitare.

V. 6 Për luftën kundër akteve terroriste

Shqipëria angazhohet plotësisht për të përmbushur në mënyrë aktive dhe t'u përkushtuar me të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e saj në luftën globale kundër terrorizmit, duke e konsideruar atë si rrezikun dhe armikun numër një të paqes, sigurisë dhe demokracisë në botë.

- Pengimi i përdorimit të territorit shqiptar si bazë për planifikimin, organizimin, kryerjen e krimeve terroriste, apo nxitjen e pjesëmarrjen në këto krime në çdo formë; përfshirë parandalimin e hyrjes së elementeve terroriste apo fitimin nga ana e tyre të statusit të refugjatit, apo të së drejtës së qëndrimit si individ apo kolektiv, për t'u organizuar trajnuar, gjetjen e armëve apo çdo aktivitet tjetër i kamufluar.

- Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimeve me shtetet e tjera kontraktuese, në veçanti me SHBA-ne dhe vendet e tjera për problemet e luftës kundër terrorizmit.

- Forcimi i sistemeve për zbulimin e transportit, eksportimit, grumbullimin e armëve municionëve dhe eksplozivëve e armëve të tjera të dëmtimit në masë.

- Forcimin e mekanizmave për sigurinë dhe mbrojtjen e vaçantë të personave të rëndësishëm.

- Forcimin e mekanizmave për sigurinë dhe mbrojtjen instalimeve kryesore, impianteve, objekteve të rëndësishme shtetërore dhe private dhe mjetet e transportit publik, për parandalimin e akteve terroriste.

- Vënien në zbatim për mbrojtjen dhe sigurinë e personave dhe misionëve diplomatike dhe konsullore; të organizatave ndërkombëtare dhe rajonale të akredituara në vendin tonë, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat rregullojnë këtë fushë.

- Rritjen e masave të sigurisë dhe koordinimin me çdo shtet në lidhje me informimin, me qëllim për të ekspozuar objektivat e grupeve dhe organizatave terroriste, të pengojë skemat e tyre dhe të bëjë të ditur rrezikun që paraqesin për sigurinë dhe stabilitetin.

- Të krijojë bazën e të dhënave për mbledhjen dhe analizën e informacioneve mbi elementet, grupet, lëvizjet dhe organizatat terroriste, si dhe të monitorojë zhvillimet në lidhje me fenomenin e terrorizmit dhe të eksperiencave të sukseshme në luftën kundër tij. Ky informacion duhet rifreskuar dhe të shkëmbehet me autoritet kompetente të shteteve të tjera, sipas kufizimeve të marrëveshjeve dhe procedurave.

V. 7 Lufta kundër korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit është e lidhur ngushtësisht me luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme e terrorizmit, si dhe është një fenomen që ngjall shqetësim në komunitet.

Përparësitë themelore të punës së institucioneve të shtetit do të përqëndrohen në fushat e mëposhtme.

Parandalimi, transparenca, gjithëpërfshirja dhe edukimi.

- Forcimi i sistemit politik dhe i etikës së funksionimit publik, duke përfshirë financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore, reformimin e sistemit zgjedhor, rregullimin e veprimtarive të lobimit dhe rishikimin e mekanizmave vetërregullues.

- Modernizimi dhe konsolidimi i procedurave, duke përfshirë reforma rregullatore të licensimit dhe shërbimeve publike.

- Reformat sektoriale (kontrolli, klima e biznesit, shërbimi civil, prokurimi publik, arsimi, shëndetësia, financat, drejtësia, pushteti vendor, etj.); për shembull, ligji i ri për prokurimin publik, me

mbështetjen e Agjencisë së Prokurimeve Publike, do të përmirësojë ndjeshëm transparencën e procedurave, duke kërkuar tendera të hapur.

- Konsolidimi i transparencës dhe integritetit në administratën publike nëpërmjet mundësisë së lirë dhe të plotë për t'u njohur me të dhënat mbi veprimtarinë e institucioneve publike dhe realizimi e 'e-government' në nivelin e qeverisjes qendrore.

- Përafrimi i legjislacionit, veçanërisht përputhshmëria e kuadrit ligjor me konventat penale e civile kundër korrupsionit të Këshillit të Europës dhe vënja në zbatim e detyrimeve të konventës së Kombëve të Bashkuara kundër korrupsionit

- Fushatat informuese dhe masa edukuese të qëndrueshme.

- Hetimi dhe dënimi i korrupsionit.

- Sigurimi i efektshmërisë së ndjekjes penale dhe rritjes së shpejtësisë së gjyqimit.

- Rritja e integritetit dhe rezistencës ndaj korrupsionit në sistemin e drejtësisë.

- Forcimi i mjeteve administrative në luftën kundër korrupsionit.

- Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e korrupsionit.

- Konsolidimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të brendshëm e ndërkombëtar.

- Konsolidimi i mekanizmave në bashkëpunimin ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit.

- Konsolidimi i mekanizmave të qëndrueshëm për shkëmbimin periodik të informacionit.

- Zbatimi i efektshëm i instrumenteve antikorrupsion rajonale e ndërkombëtare.

Lufta e nisur kohët e fundit do të thellohet deri në vënien para përgjegjësisë të të gjithë personave fajtores, deri në eliminimin e shkaqeve që bëjnë të mundur penetrimin e saj në institucionet shtetërore, si dhe marrjen e masave për parandalimin e metejshëm të zhvillimit të korrupsionit.

Qeveria Shqiptare është e angazhuar plotësisht në këto lufte, duke e vendosur atë si një prioritet të saj.

Masat e marra synojnë në këto drejtime:

- Në implementimin e akteve ndërkombëtare e ato ligjore me synim krijimin e një legjislacioni të plotë për të parandaluar korrupsionin.

- Në ndërhyrjen, shtesat, amendimin e legjislacionit me synimin eliminimin e mundësive për të kryer korrupsion

- Vënien në punë të strukturave tashmë të krijuara si njësi e përbashkët e hetimit, bazuar në memorandumit e firmosur midis MB,PP, MF e SHISH

- Forcimin e kontrollit të brendshëm në institucionet shtetërore

- Krijimin e strukturave operuese në gjithë vendin në Policinë e Shtetit për të luftuar korrupsionin.

- Krijimin e sistemeve të informimit e bashkëpunimit me komunitetin për të luftuar korrupsionin.

- Krijimin e një database për informacionin në lidhje me korrupsionin për grumbullimin e analizimin e informacionit si dhe marrjen e masave për parandalimin e tij.

- Ndërgjegjësimin e komunitetit për rrezikun nga korrupsioni si dhe pasojat e tij në jetën shoqërore të evndit.

- Zhvillimin e hetimeve të plota për rastet e korrupsionit duke synuar në identifikimin e faktorëve që krijuan korrupsionin, lidhjen e tij me vepra penale të tjera e sidomos me krimin e organizuar, si dhe eliminimin e tyre.

V.8 Mbrojtja e dëshmitarëve

Politikat për mbrojtjen e dëshmitarëve:

- Rritja e efektivitetit të programit për mbrojtjen e dëshmitarëve e bashkëpunorëve të drejtësisë do të jetë prioritet i punës i Qeverisë. Ajo do të kërkojë:

- hartimin e një ligji të plotë e sipas standarteve evropiane për mbrojtjen e dëshmitarëve e bashkëpunorëve të drejtësisë;

- zhvillimin e udhëzimeve për personelin e sistemit të drejtësisë për rastet kur duhet të kërkojnë programe mbrojtje;

- rritjen e bashkëpunimit midis agjencive të ndryshme për mbrojtjen e dëshmitarëve si prokurori, gjykatë, polici etj.

- realizimin e trajnimeve për policinë, prokurorinë, gjykatën etj lidhur me praktikat më të mira të mbrojtjes së dyshimtarëve;

- rritjen e fondeve e kapaciteteve për Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve;
- marrjen e masave që synojnë bashkëpunimin mbështetës ndërkombëtar me qëllim lejimin e programeve të mbrojtjes edhe jashtë kufijve;
- përdorimin e telekomunikimeve audiovizive për dhënien e dëshmive në gjykatë, kur prania e tyre atje është e pamundur;
- promovimi i shkëmbimit të praktikave më të mira midis vendeve evropiane, si dhe përdorimi i rrjeteve të ekspertëve të europolit për mbrojtjen e dëshmitarëve.

OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

Për të arritur vizionin si dhe realizuar misionin e strategjisë përcaktohen objektiva të përgjithshme si dhe objektiva afatshkurtra, afatmesme e afatgjata.

- Objektiva afatshkurtra janë ato që do të arrihen në periudhën gjatë vitit 2008.
- Objektiva afatmesme janë ato që do të arrihen në periudhën 2009-2010.
- Objektiva afatgjata janë ato që do të arrihen në periudhën 2011-2013.

Objektivat e kësaj strategjie do të adoptohen në strategjitë tjera sektoriale. Ato nuk do të zëvendësojnë objektivat e paraqitura në to, por do të jenë zgjerim e thellim i tyre dhe masat për realizimin e këtyre objektivave do të paraqiten në planet e veprimit të gjithë institucioneve shtetërore e të tjera që marrin detyrime nga kjo strategji dhe nga strategjitë sektoriale që lidhen me krimin e organizuar, trafiqet e paligjshme e terrorizmin.

Kushti kryesor për përmbushjen e objektivave të kësaj strategjie është rritja e bashkëpunimit, marrja e detyrimeve nga të gjitha institucionet dhe aktorët duke synuar një reagim proaktiv të të gjithë agjencive të zbatimit të ligjit kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme e terrorizmit.

V. 8 Objektiva afatshkurtra: (shkurt 2008 – dhjetor 2008)

- Ripunimi e azhurnimi i gjithë planeve të veprimit të hartuara deri në miratimin e kësaj strategjie, hartimi i planeve të veprimit të reja nga gjithë institucionet që nuk kanë patur të tilla deri tani dhe që marrin detyra sipas drejtimeve të krimit të organizuar e terrorizmit.

- Planet e veprimit të hartohen sipas fazave që përcakton kjo strategji.

- Krijimi i strukturave sipas kërkesave apo të parashtruara në strategjitë e tjera, rishikimi i komiteteve, komisioneve, sekretarive apo çdo funksion tjetër i krijuar nga strategjitë sektoriale me qëllim zgjerimin e kompetencave apo funksionimin e tyre për gjithë drejtimet e luftës kundër krimit të organizuar e terrorizmit.

- Hartimi dhe përqsja e legjislacionit sipas standardeve të BE, në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme e terrorizmit, luftën kundër korrupsionit, si dhe akteve të tjera të funksionimit të strukturave që kanë përgjegjësi për këtë drejtim, bazuar në strategjitë e tjera si dhe në planet e veprimit.

- Hartimin e gjithë akteve të nevojshme që do të thellojnë bashkëpunimin me struktura homologe të vendeve të rajonit e me gjerë në luftën kundër krimit të organizuar ndërkufitar e formave të ndryshme të krimit të organizuar, korrupsionit apo terrorizmit.

- Krijimin i një sistemi të transmetimit të informacionit brenda strukturave të përfshira në luftën kundër krimit të organizuar.

- Minimizimin e përdorimit të drogave në vend, si dhe parandalimin e kultivimit të bimës së kanabis sattivës.

- Përfundimin e sistemeve të IT për transmetimin e analizën e informacionit që bën fjale për vepra penale të krimit të organizuar e terrorizmit.

- Zgjerimin e aplikimit të teknikave të reja të investigimit, brenda suazës së përcaktuar në ligj, për gjithë format e shfaqjes së krimit të organizuar.

- Identifikimin e analizën e situatës së grupeve kriminale që kryejnë, apo dyshohet se kryejnë vepra penale të lidhura me krimin e organizuar e terrorizmin.

- Realizimin e trajnimeve të vazhdueshme profesionale për specialistët që punojnë në strukturat që kryejnë veprimtari kundër krimit të organizuar e terrorizmit. Shfrytëzimin e eksperiencave të vendeve të tjera në këtë drejtim.

- Zhvillimi dhe thellimi i transparencës për komunitetin në lidhje me goditjen e krimit të organizuar.

V.9 Objektiva afatmesme (2009-2010)

- Realizimin e një kontrolli të kufirit shtetëror, apo të te huajve, duke ju përafuar standardeve

të vendeve të BE.

- Realizimin e një sistemi të plotë të informimit për tentativa të pastrimit të parave nga Drejtoria e Përgjithshme kundër Pastrimit të Parave .

- Hartimi dhe përfaqja e legjislacionit sipas standardeve të BE, në lidhje me luftën kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave si dhe vënien në përdorim të sendeve apo mallrave që rrjedhojnë nga një krim.

- Krijimin e një baze të dhënash për gjithë shqiptarët që janë shpallur fajtor dhe janë dënuar nga gjykatat e vendeve të huaja, janë duke kryer dënimin apo e kanë kryer atë, për vepra penale që përcaktohen si krim i organizuar apo trafikë të paligjshme.

- Krijimin e një baze të dhënash për shtetasit shqiptarë që banojnë jashtë vendit dhe që ka informacione se kryejnë vepra penale në ato vende në lidhje me krimin e organizuar, trafikë të paligjshme, pastrim parash e terrorizëm.

- Thellimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit si dhe me ato homologe të vendeve të tjera për luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit.

- Venien në efikasitet të plotë të një sistemi analitik të informacionit që bën fjalë për krim të organizuar e terrorizem, realizimin e shkëmbimit të informacionit me shpejtësi e cilësi si dhe përqëndrimin e tij në strukturat e Policisë së Shtetit.

- Kryerjen e studimeve të plota për ecurinë e punës në drejtim të goditjes e parandalimit të formave të ndryshme të krimit të organizuar, përcaktimin e nevojave materialo financiare për strukturat që operojnë në këtë drejtim dhe plotësimin e tyre mbi bazën e mundësive që ka çdo institucion.

- Ngritjen e një sistemi raportimi e monitorimi për rezultatet e hetimeve e gjykimeve të rasteve të krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme e terrorizmit, të sekuestrimit të pasurive që rrjedhojnë nga veprimtaria kriminale si dhe tentativave të pastrimit të parave.

- Kryerjen e analizave të përbashkëta midis institucioneve të gjurmimit, hetimit e gjykimit lidhur me grupe kriminale të hetuara e gjykuara për krime të organizuar e terrorizëm., në funksion të marrjes se masave parandaluese.

- Krijimin e një sistemi të informatizuar statistikor midis institucioneve që gjurmojnë, hetojnë apo gjykojnë çështje të krimit të organizuar e terrorizmit.

V. 10 Objektivat afatgjata (2011-2013)

- Realizim i parandalimit të krimit të organizuar në gjithë format që paraqitet ai dhe minimizim i veprave penale që lidhen me krimin e organizuar e trafiket e paligjshme si dhe luftën kundër korrupsionit duke arritur në standardet e vendeve më të zhvilluara në këtë drejtim.

- Realizim i parandalimit të akteve të mundshme terroriste në vendin tonë apo nëpërmjet vendit tonë.

- Hartim i një sistemi ligjor apo akteve të tjera sipas standardeve të BE dhe që krijon hapësirën e duhur apo instrumentet e nevojshme për parandalimin e goditjes e krimit të organizuar e terrorizmit.

- Paraqitje e strukturave të specializuara të shtetit të afta profesionalisht dhe të angazhuara maksimalisht në drejtim të identifikimit e goditjes së krimit të organizuar

- Realizim i goditjes së gjithë grupeve kriminale që kryejnë apo kanë kryer veprimtari të krimit të organizuar, të evidencuara në fazën e parë dhe të dytë të kësaj strategjie, duke identifikuar moton “se asnjë person apo grup kriminal që kryen krime të formave të krimit të organizuar nuk do ti shpëtojë ndëshkimit të ligjit”.

- Paraqitja e strukturave të shtetit shqiptar si partnere të aftë profesionalisht, të barabartë dhe të besueshëm për strukturat homologe të vendeve të tjera.

KREU VI

Procesi i monitorimit e vlerësimit

VI.1 Përgjegjësitë e institucioneve të veçanta

Per përgatitjen, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Luftes kundër Krimit të Organizuar është ngritur Grupi Ndërmintor i Punës me urdhër të Kryeministrit nr.164, datë 27.07.2006. në zbatim të këtij Urdhri, çdo institucion i përfshirë në këtë strategji do të hartojë detyra dhe masa konkrete për zbatimin e saj.

Menjëherë me miratimin e kësaj strategjie, do të bëhen pjesë e saj gjithë objektivat dhe masat e parashikuara për tu marrë në planet e veprimit të hartuara në strategjitë sektoriale të formave të

krimit të organizuar, në strategjitë për zhvillim, në planet e veprimit të hartuara përveç këtyre strategjive si dhe në programet apo planet e veçanta të punës të çdo institucioni ku parashikohen detyra për luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, pastrimit të parave e terrorizmit.

Për vetë mënyrën e ndërtimit që ka kjo strategji, ajo nuk shmang strategjitë e tjera, por synon në thellimin e masave për implementimin e plotë të tyre.

Detyra për institucionet:

- Të marrin detyrimet e përcaktuara në këtë strategji dhe në strategjitë e tjera sektoriale të luftës kundër krimit të organizuar e terrorizmit dhe të hartojnë plane veprimi apo programe pune për implementimin e tyre sipas fazave të parashikuara në këtë strategji.

Planet e veprimit apo programet e punës do të bëhen pjesë e kësaj strategjie dhe do të monitorohen bashkërisht.

- Të ngrenë menjëherë grupet e punës për implementimin e detyrave të tyre si dhe të përcaktojnë pikat e kontaktit, përgjegjëse për raportimin e koordinimit e zbatimit të detyrave të përcaktuara në strategji.

1. Ministria e Brendshme (Policia e Shtetit)

- Të marrë përgjegjësinë e hartimit të nismave për koordinim si dhe bashkëveprim midis institucioneve të ndryshme të përmendura në këtë strategji.

- Të grumbulloje planet e veprimit apo programet e punës të gjithë institucioneve të tjera dhe ti bëjë pjesë të kësaj strategjie.

- Të marrë iniciativën për ripunimin e azhornimin e strategjive të tjera sektoriale me politikat dhe objektivat e parashikuara në këtë strategji.

2. Ministria e Drejtësisë

- Të hartojë detyra të veçanta në zbatim të objektivave të strategjisë dhe të japë ndihmesën e saj në hartimin e akteve ligjore të parashikuara në këtë strategji si dhe në strategjitë sektoriale.

- Të kërkojë instrumentet e nevojshme për inspektimin e vendimeve të dhëna kundër autorëve të krimit të organizuar e terrorizmit etj.

3. Ministria e Financave

- Të nxjerrë urdhra dhe udhëzime të posaçme në zbatim të ligjit të ri nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” dhe MoU ndërinstitucionale të nënshkruar nga institucionet partnerë të fushës në lidhje me detyrimet e këtyre institucioneve (DPPPP, DPD, DPT, AAPSK), si dhe format dhe mënyrat konkrete të bashkëpunimit në këtë fushë.

4. Prokuroria

- Të hartojë detyra të veçanta për zbatimin e objektivave të përcaktuara në këtë strategji për organin e prokurorisë.

5. Shërbimi Informativ Shtetëror

Të hartojë detyra të veçanta për zbatimin e objektivave në drejtim të luftes kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, pastrimit të parave si dhe luftën kundër terrorizmit.

6. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta

- Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të parashikuara në këtë strategji sidomos në eliminimin e pasojave të ardhura nga krimi i organizuar për trajtimin e viktimave të trafikut etj.

7. Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

- Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të parashikuara në këtë strategji sidomos për marrjen e masave të pengimit të trafikut të mjeteve motorike nëpërmjet një sistemi perfekt të regjistrimit e kontrollit të mjeteve.

8. Ministria e Mbrojtjes

- Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të strategjisë për këtë institucion, sidomos në drejtim të shkëmbimit të informacionit, në krijimin e kapaciteteve dhe aseteve ushtarake për përdorim të integruar të tyre edhe nga institucionet e tjera shtetërore si dhe për vënien e tyre në dispozicion të organizmave ndërkombëtar në kuadër të luftës kundër terrorizmit.

9. Ministria e Punëve të Jashtme

- Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie sidomos në fushën e bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me homologet e huaj e organizatat ndërkombëtare.

10. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

- Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie duke u fokusuar;

“Për luftën kundër fenomenit të përdorimit, abuzimit dhe shpërndarjes së drogës në mjediset shkollore”; për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe përfshirjen e të miturve në kriminalitet; përfshirja në kurrikula e temave për parandalimin e trafikimit të qënieve njerëzore, etj.

11. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

- Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie duke u fokusuar në masat për “Për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike” etj.

12. Ministria e Shëndetësisë

- Të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie sidomos në drejtim “Për forcimin e masave të kontrollit kundër prekursorëve dhe drogave që përdoren në shëndetësi”.

VI.2 Monitorimi

Monitorimi është procesi i pasqyrit të implementimit të strategjise së luftës kundër krimit të organizuar e terrorizmit si dhe arritjen e objektivave të parashikuara për këtë qëllim.

Ligji nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, parashikon ngritjen e Komitetit Këshillues për Masat kundër Krimit të Organizuar pranë Këshillit të Minsitrave, e cila do të jetë struktura përgjegjëse për monitorimin e kësaj Strategjie. Deri në ngritjen dhe vënien në funksionim të këtij Komiteti, kjo përgjegjësi i përket Grupit Ndërmnistror të Punës në zbatim të urdhrat të Kryeministrit nr.164, datë 27.7.2006 dhe Sekretariatit Teknik, të ngritur me urdhër të Ministrit të Brendshëm. Ministria e Brendshme nëpërmjet Sekretariatit Teknik do të përgatisë buletinin 3-mujor, bazuar në raportimet që do të bëjnë institucionet e tjera.

Në strategji është parashikuar që përgjegjësinë e hartimit të nismave për koordinim, si dhe bashkëveprim midis institucioneve të ndryshme të përmendura në këtë strategji ta ketë Ministria e Brendshme e cila nëpërmjet Sekretarit Teknik:

- Të grumbullojë detyrat e veçanta të të gjithë institucioneve të tjera;
- Të marrë inisiativën për ripunimin e azhurnimin e strategjive të tjera sektoriale me politikat dhe objektivat e parashikuara në këtë strategji.

Monitorimi i këtyre rezultateve do të jetë i brendshëm dhe i jashtëm. Monitorimi i brendshëm do të vlerësojë progresin e bërë duke u mbështetur të indikatorët:

- Si indikatorë të brendshëm do të jenë:
 - shkatërrimit të grupeve kriminale të përfshira në këto aktivitete;
 - sekuestrimin e pasurive të rrjedhura nga këto aktivitete të paligjshme;
 - arrestimin e personave me karriere kriminale;
 - treguesit e tregut të paligjshëm;
 - minimizimin e korrupsionit dhe renditjen e Shqipërisë në vendet që luftojnë me efektivitet korrupsionin;
 - përdorimin e formave dhe mjeteve të vecanta të hetimit;
 - paraqitja e një shtate të sigurtë në vend e standarte të mira të rendit.

Si indikatorë të jashtëm do të jenë:

- vlerësimet e publikut, qytetareve dhe bizneseve të ndryshme nëpërmjet matjes së perceptimit të publikut duke përdorur pyetesore, intervista dhe organizuar forume të hapura;
- vlerësimet e institucioneve ndërkombetare, në raporte periodike apo buletine;
- vlerësimet e vendeve të rajonit për treguesit e minimizimit të krimit të organizuar në Shqipëri.

Të gjitha institucionet e tjera do të dërgojnë një raportim të plotë për masat e marra lidhur me implementimin e kësaj strategjie, si dhe strategjive të tjera çdo fund 3-mujori në Ministrinë e Brendshme duke shpjeguar dhe arritjet e realizuara nga implementimi i masave.

Qeveria do të marrë në analizë punën e institucioneve të përmendura në këtë strategji në drejtim të luftës kundër krimit të organizuar e terrorizmit çdo vit si dhe do të bëjë publike arritjet pas çdo faze të implementimit të objektivave e planeve të veprimit, si dhe pasqyrojë arritjet kundër krimit të organizuar.

VENDIM

Nr.1160, datë 13.8.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ETALONET KOMBËTARE TË MATJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 12 të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për etalonet kombëtare të matjes”, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE **PËR ETALONET KOMBËTARE TË MATJES**

1. Të përgjithshme
 - bazat për ngritjen e sistemit të etaloneve kombëtare të matjeve;
 - kërkesat për njohjen e etalonit të matjeve si etalon kombëtar;
 - të drejtat dhe detyrat e institucionit ligjor që ka realizuar, ruan dhe mirëmban një etalon matjeje (këtej e tutje referohet si mbajtës i etalonit kombëtar të matjes), i cili është njohur si etalon kombëtar matjeje nga Këshilli i Ministrave;
 - monitorimin e mirëmbajtjes dhe plotësimit të detyrave të mbajtësit të etalonit kombëtar të matjes.
2. Terminologjia
 - Etalon matjeje: Realizimi i përkufizimit të një madhësie të dhënë, me vlerën e madhësisë dhe pasigurinë e matjes së shpallur.
 - Etalon kombëtar matjeje: Etalon i njohur nga Këshilli i Ministrave për t’u ruajtur në një laborator, i cili do të shërbejë si bazë për transmetimin e vlerave të njohura të standardet e tjera të së njëjtës madhësie fizike. Etaloni kombëtar i matjes mund të realizohet dhe ruhet si nivel primar apo sekondar.
 - Etalon primar: Etalon matjeje, vlera e madhësisë dhe pasiguria e matjes së të cilit janë realizuar duke përdorur një procedurë matjeje primare.
 - Etalon sekondar: Etalon matjeje, vlera e madhësisë dhe pasiguria e matjes janë përcaktuar nëpërmjet një etaloni primar matjeje të madhësisë së të njëjtës natyrë.
 - Material referues: Materia me një ose më shumë cilësi lidhur me homogjenitetin e mjaftueshëm dhe stabile, përdorur për kalibrim, për përcaktimin e një vlere të një materiali tjetër ose për sigurimin e cilësisë.
3. Bazat për ngritjen e sistemit të etaloneve kombëtare të matjeve

DPM-ja planifikon dhe siguron transmetueshmërinë e matjeve në nivelin ndërkombëtar dhe transferimin e vlerave të njësive të matjeve për disa madhësi fizike në laboratorët e saj metrologjikë. Për madhësi të tjera, siç përcaktohet në strategji, bashkëpunon me laboratorët metrologjikë të institucioneve të tjera ligjore.

Sistemi i etaloneve kombëtare të matjeve në Republikën e Shqipërisë bazohet, së pari në sigurimin e etaloneve kombëtare të matjeve të nivelit primar dhe sekondar për njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar dhe ato derivate (këtej e tutje referohet si “SI”), me synim arritjen e transmetueshmërisë në një diapazon sa më të gjerë të mundur për kalibrime dhe matje në vend.

Etalonet kombëtare të matjeve, përmendur në paragrafin e mësipërm, janë të tilla që të sigurojnë një mbarëvajtje të pashqetësuar të sistemit metrologjik kombëtar, në linjë me nevojat dhe kapacitetet kombëtare.

DPM-ja koordinon aktivitetet metrologjike të mbajtësve të etaloneve kombëtarë të matjeve që lidhen me problematiken e këtij vendimi dhe i ndihmon ato të marrin pjesë në aktivitetet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare.

4. Kushtet për njohjen e etalonit të matjes si etalon kombëtar të matjes

Një etalon matjeje njihet si etalon kombëtar, me kusht që mbajtësi ligjor, i cili ka realizuar, ruan dhe mirëmban etalonin:

- të ketë marrë paraprakisht akreditim për realizimin e kalibrimeve ose matjeve referuese të nevojshme për të siguruar transmetueshmërinë e matjeve, në përputhje me standardet e matjes respektive;

- në mënyrë të pavarur, të sigurojë kushtet mjedisore, etalonet, pajisjet suplementare dhe aksesoret e domosdoshëm për arritjen e transmetueshmërisë së matjeve;

- të ketë kontribute origjinale të ekspertëve të stafit të vet në ngritjen e transmetueshmërisë së matjeve, të hartimit të metodave të matjeve, hardware-ve, software-ve dhe bibliografi për fushën që trajtohet;

- të ketë realizuar një survejim të situatës prezente në vend për kalibrime të nivelit më të lartë dhe të nevojave për periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë për këtë qëllim, si dhe survejim të situatës botërore;

- të ketë përgatitur një strategji për zhvillimin e aktivitetit kalibruar në laboratorin e tij metrologjik, si dhe në lidhje me nevojat në Republikën e Shqipërisë;

- të përcaktojë nivelin e pasigurisë së matjeve dhe diapazonin e madhësisë fizike për të cilin kërkon të akreditohet.

5. Aktivitetet dhe detyrat e mbajtësit të etalonit kombëtar të matjes

5.1 Mbajtësi i etalonit kombëtar të matjeve realizon aktivitetet e mëposhtme:

- ndjekjen në vazhdimësi dhe pa probleme transmetueshmërinë e matjes së madhësisë fizike të caktuar;

- performancën aktive në fushën e metrologjisë për madhësinë fizike të zgjedhur;

- ndjekjen e nevojave të metrologjisë në Republikën e Shqipërisë dhe të prirejeve botërore për madhësinë fizike të zgjedhur dhe adaptimin e tyre në koordinim me DPMK;

- pjesëmarrjen në përmirësimin e etaloneve dhe rregullave teknike lidhur me etalonet e matjes;

- pjesëmarrjen, kur caktohet, në projekte metrologjike ndërkombëtare dhe ndërkrahësime;

- takimet e punës për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga pika 7 më poshtë (këtej e tutje referohet “Kontratë”).

5.2. Mbajtësi i etalonit kombëtar të matjes lejohet t’i përdorë pajisjet etalon që kanë statusin e etalonit kombëtar të matjes vetëm për:

- ruajtjen e transmetueshmërisë së matjes;

- realizimin e ndërkrahësimeve dhe pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;

- qëllime kërkimore, që të përmirësojë parametrat metrologjikë. Pajisjet e përmendura në paragrafët e mësipërm duhet të përdoren për qëllimet e treguara vetëm nga stafi kompetent, i cilësuar në kontratë.

6. Kontra tip

6.1 Monitorimi i performancës, plotësimi i detyrimeve të mbajtësit të etalonit kombëtar të matjes dhe kushtet e arsytet për anulimin e deklaramit të tij

DPM-ja kërkon ndaj mbajtësit të etalonit kombëtar të matjes të nënshkruajë një kontratë siguracioni për dëmet që ai mund t’i shkaktojë me aktivitetin e tij një personi të tretë. Gjithashtu, DPM-ja kërkon ndaj mbajtësit të etalonit kombëtar të matjes të nënshkruajë një kontratë siguracioni për sigurimin e etalonit kombëtar të matjes dhe pajisjet e tjera të domosdoshme për mirëmbajtjen e transmetueshmërisë së matjes, për raste të dëmtimeve apo avarive gjatë punës apo transportit.

DPM-ja monitoron mbarëvajtjen dhe plotësimin e detyrimeve të mbajtësit të etalonit kombëtar të matjes, siç tregohet në pikën 5 dhe realizuar në kontratë, në bazë të dokumenteve të paraqitura dhe inspektimeve të bëra. Nëse DPM-ja sheh se ka parregullsi ose devijime në performancën e mbajtësit të etalonit kombëtar të matjeve, ajo i propozon Këshillit të Ministrave të nxjerrë një vendim që ndërpret njohjen e etalonit të matjes si etalon kombëtar të matjes. Në vendimin e ndërprerjes, DPM-ja duhet të tregojë devijimet e gjetura dhe të përcaktojë kërkesat brenda të cilave duhen riparuar devijimet. Për periudhën e kohës derisa të riparohen devijimet, DPM-ja gjithashtu ndërpret dhënien e fondeve të përcaktuara në kontratë.

Ndërprerja e njohjes së etalonit të matjes si etalon kombëtar ose ndërprerja e përkohshme e fondeve mund të zgjasë maksimumi 12 muaj. Nëse mbajtësi i etalonit kombëtar të matjes dështon në ndreqjen e devijimeve brenda kërkesave të dhëna, Këshilli i Ministrave shfuqizon vendimin e njohjes

së etalonit të matjes si etalon kombëtar dhe nuk i jep më fonde. Në këtë rast DPM do t'i kërkojë mbajtësit, ndaj të cilit është marrë vendim për njohjen e etalonit të matjes si etalon kombëtar dhe me pas ky vendim është shfuqizuar, të kthejë paratë e marra në 12 muajt e fundit plus interesin.

Në raste të shkeljes serioze të kontratës nga mbajtësi i etalonit kombëtar të matjes në realizimin e aktivitetit të tij dhe plotësimin e detyrimeve, DPM-ja i propozon Këshillit të Ministrave shfuqizimin e vendimit për njohjen e etalonit të matjes si etalon kombëtar, pa pasur ndërprerje të mëparshme të njohjes. Në këtë rast, gjithashtu DPM-ja kërkon nga mbajtësi, ndaj të cilit është marrë vendim për njohjen e etalonit të matjes si etalon kombëtar dhe është marrë më pas vendim për anulim të njohjes, të kthejë paratë e marra në 12 muajt e fundit plus interesin.

6.2 Elementet e kontratës ndërmjet DPM-së dhe mbajtësit të etalonit kombëtar të matjes

DPM dhe mbajtësi i etalonit kombëtar të matjes nënshkruajnë një kontratë, e cila përmban në veçanti:

- mënyrat e financimit të fondeve mbajtësit të etalonit kombëtar të matjes;
- pronësinë e pajisjeve, në rast se kjo jepet nga DPM-ja;
- siguracionin që duhet të bëjë mbajtësi i etalonit kombëtar të matjes;
- dokumentet që duhen paraqitur nga mbajtësi i etalonit kombëtar të matjes;
- kapacitetet më të mira matëse;
- procedurat e njoftimit për DPM-në për ndryshimet lidhur me performancën e aktiviteteve dhe plotësimin e detyrimeve të mbajtësit të etalonit kombëtar, si jepen në pikën 6.1 dhe në kontratë;
- listën e stafit kompetent, përfshirë dhe personin përgjegjës të laboratorit dhe zëvendësin e tij;
- pjesëmarrjen në veprimtari ndërkombëtare të metrologjisë;
- bashkëveprimin e veprimtarive të laboratorit kombëtar të matjeve drejt njohjes ndërkombëtare
- shkëmbimin e informacionit midis DPM-së dhe mbajtësve të etaloneve kombëtare;
- detyrimin mbajtësit të etaloneve kombëtare të deklaruar të informojë menjëherë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë për çdo ndryshim në statusin e akreditimit;
- kushtet e zgjatjes së kontratës;

7. Kushtet në të cilat DPM-ja mban dhe ruan etalonet kombëtare të matjeve

Për mbajtjen dhe ruajtjen e etaloneve kombëtare të matjeve DPM-ja do të plotësojë kërkesat e parashikuara në këtë vendim.

VENDIM

Nr.1161, datë 13.8.2008

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR SHISHET ENËMATËSE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 36 të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për shishet enëmatëse”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit të tij nga data 16 mars 2009.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

RREGULLORE

PËR SHISHET ENËMATËSE

PJESA I

PËRMBAJTJA

1. Kjo rregullore specifikon:
 - 1.1 Shishet enëmatëse ligjërisht të kontrolluara.
 - 1.2 Kërkesat metrologjike ndaj shisheve enëmatëse.
 - 1.3 Metoda referuese për kontrollin e volumit neto (kapaciteti aktual) të shisheve.
 - 1.4 Mbishkrimet dhe shenjat që vendosen mbi shishet si enëmatëse.

PJESA II SHISHET LIGJËRISHT TË KONTROLLUARA

2. Kjo rregullore do të zbatohet për enët e bëra prej qelqi ose çdo material tjetër që kanë qëndrueshmëri dhe stabilitet dhe që ofrojnë të njëjtat garanci metrologjike si qelqi, kur enë të tilla:

2.1 janë të mbyllura ose të disenjuara për t'u mbyllur dhe kanë si qëllim magazinimin, transportin ose tregtimin e lëngjeve;

2.2 kanë kapacitet nominal midis 0.05 litra dhe 5 litra, përfshirë këto dy vlera;

2.3 kanë karakteristika metrologjike (karakteristikat e disenjos dhe uniformitetin e prodhimit), të tilla që ato mund të përdoren si enëmatëse p.sh kur janë të mbushura deri në një nivel ose përqindje të caktuar të kapacitetit të tyre “deri në buzë” dhe përmbajtja e tyre mund të matet me saktësi të mjaftueshme.

PJESA III KËRKESAT METROLOGJIKE PËR SHISHET SI ENËMATËSE

3. Kapaciteti nominal, kapaciteti “deri në buzë” dhe kapaciteti aktual i një shisheje do të përcaktohet në temperaturën 20⁰ C.

3.1 Shishet enëmatëse do të mbushen:

a) në një nivel konstant që i korrespondon nivelit teorik të mbushjes për kapacitetin nominal;

b) në një boshllëk konstant që i korrespondon diferencës ndërmjet kapacitetit “deri në buzë” dhe kapacitetit nominal.

3.2 Të gjitha shishet e një disajni, përmasë dhe kapaciteti nominal do kenë:

a) një diferencë të perceptueshme konstante ndërmjet nivelit teorik të mbushjes për kapacitetin nominal dhe nivelit “deri në buzë”;

b) një diferencë të perceptueshme konstante ndërmjet kapacitetit “deri në buzë” dhe kapacitetit nominal, i njohur si volumi i zgjerimit ose boshllëku.

3.3 Shishet do të prodhohen të tilla që diferenca ndërmjet kapacitetit aktual dhe kapacitetit nominal të treguar të mos kalojë gabimin maksimal të lejuar.

3.4 Gabimi maksimal i lejuar, referuar pikës 3.3, pozitiv ose negativ, do të jetë në përputhje me aneksin 1.

3.5 Gabimi maksimal i lejuar i kapacitetit të treguar “deri në buzë”, të një shisheje do të jetë i njëjti si dhe gabimi maksimal i lejuar për kapacitetin nominal korrespondues.

3.6 Shishet që plotësojnë kërkesat referuar pikës 3.3, do të shënohen me shenjë “s” të parashikuar në pjesën V, mund të përdoren si enë matëse dhe do të hidhen në treg pa asnjë testim ose kontroll metrologjik ligjor paraprak. Shenja Evropiane “3” njihet nga autoritetet shqiptare. Shishet e ardhura nga një vend anëtar i BE-së dhe janë të shënuara me shenjë “3” do të hidhen në treg pa asnjë testim ose kontroll metrologjik ligjor paraprak pasi të konfirmohet dokumentarisht vlefshmëria e vendosjes në produkt të kësaj shenje.

3.7 Prodhuuesit e shisheve do të sigurojnë konformitetin e kapacitetit të tyre me kërkesat e pikës 3.3, nëpërmjet kryerjes së kontrolleve statistikore të prodhimit sipas aneksit 2.

3.8 Në prodhimin e shisheve enëmatëse, shfrytëzimi sistematik i tolerancave është i ndaluar.

PJESA IV METODA REFERENCE PËR KONTROLLIN E VOLUMIT NETO (KAPACITETIT AKTUAL) TË SHISHEVE

4. Kërkesat ndaj metodave dhe instrumenteve matëse, që përdoren për përcaktimin e

kapacitetit aktual të shisheve enëmatëse.

4.1 Kapaciteti aktual i shisheve enëmatëse do të kontrollohet nëpërmjet përcaktimit të sasisë së ujit me një densitet të njohur të mbushur deri në nivelin që teorikisht i korrespondon kapacitetit nominal.

4.2 Sasia e ujit të mbushur do të përcaktohet me peshim në 20 °C.

4.3 Kapaciteti aktual i shisheve enëmatëse mund të kontrollohet dhe në mënyrë indirekte.

4.4 Në kontrollin e kapacitetit aktual të shisheve enëmatëse, pasiguria e matjes nuk duhet të kalojë 1/5 e gabimit maksimal të lejuar për kapacitetin nominal korrespondues.

4.5 Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë do të publikojë në buletin e saj zyrtar vlerat për karakteristikat metrologjike të instrumenteve matëse që do të përdoren për kontrollin e kapacitetit aktual të shisheve enëmatëse.

4.6 Instrumentet matëse të përdorura për kontrollin e kapacitetit aktual të shisheve enëmatëse duhet të jenë të përshtatshme dhe të verifikuara nga organet përkatëse të DPM-së ose persona të autorizuar dhe të mbajnë shenja të vlefshme që e vërtetojnë këtë kontroll.

4.7 Prodhuesit e shisheve enëmatëse do të ruajnë dokumentacionin e instrumenteve matëse, që dëshmojnë që ato plotësojnë kërkesat e kësaj pjese.

4.8 Metodatat për kontrollin e kapacitetit aktual të shisheve enëmatëse do të kryhen nga:

a) prodhuesit e shisheve enëmatëse;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë gjatë kryerjes së inspektimit metrologjik sipas ligjit për metrologjinë dhe akteve nënligjore të nxjerra në mbështetje të tij.

4.9 Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë do të kryejë këtë kontroll sipas metodës referencë të paraqitur në aneksin 2.

4.10 Prodhuesit e shisheve enëmatëse do të kryejnë kontrollin statistikor të prodhimit për çdo parti prodhimi.

4.11 Kriteri i kontrollit të kapacitetit aktual përfshin shmangien (devijimin) prej:

a) shumës së kapacitetit nominal të një shisheje dhe gabimit maksimal të lejuar korrespondues të specifikuar;

b) diferencës ndërmjet kapacitetit nominal të një shisheje dhe gabimit maksimal të lejuar korrespondues të specifikuar.

4.12 Prodhuesit e shisheve do të vendosin për metodën e kontrollit, që do të përdorin dhe do të organizojnë procedurën e kontrollit, në mënyrë të tillë që të sigurojnë që partitë e tyre të prodhimit të plotësojnë kërkesat ndaj kapacitetit aktual të shisheve enëmatëse referuar pikave 3.3 deri 3.6.

4.13 Prodhuesit do të përcaktojnë, në vartësi të rezultateve të kontrollit, madhësinë e partisë së inspektimit dhe madhësinë dhe frekuencën e marrjes së mostrave.

4.14 Prodhuesit e shisheve do të dokumentojnë dhe të ruajnë regjistrimet e kontrolleve të kryera nga vetë ata.

4.15 Regjistrimet e kontrolleve do të dëshmojnë që këto kontrolle, së bashku me korrigjimet dhe rregullimet që ata i kanë parë të nevojshme, të sigurojnë që vetëm shishet enëmatëse që plotësojnë kërkesat ndaj kapacitetit aktual të tyre janë hedhur në treg.

4.16 Prodhuesit e shisheve enëmatëse do të mbajnë (ruajnë) dokumentacionin e kontrollit, i cili do të përfshijë:

a) një përshkrim të metodës së kontrollit të përdorur;

b) regjistrimet e matjeve dhe të rezultateve të përpunimit dhe kontrollit;

c) të dhëna për veprimet korrigjuese të marra, kur jokonformiteti i kapacitetit aktual të shisheve enëmatëse me kërkesat e specifikuara është eliminuar;

d) regjistrime të tjera që tregojnë vëzhgimin (vrojtimin) e metodës së kontrollit të përshkruar.

4.17 Importuesit e shisheve enëmatëse do të ruajnë dokumentacionin për kontrollin e partive të importuara, që provojnë konformitetin e kapacitetit aktual të shisheve me kërkesat e specifikuara:

a) regjistrimet referuar pikës 4.14 duhet të mbahen të sakta, të qarta, të njëkuptimshme dhe të paanshme;

b) regjistrimet që iu referohen pikave 4.14 do të ruhen në mbartës që të lejojnë magazinim të sigurt dhe mundësinë që të jenë të kuptueshme dhe lehtësisht të lexueshme;

c) regjistrimet që i referohen pikave 4.14 dhe 4.15 do të mbahen (ruhen) kronologjikisht për jo më pak se një vit nga data e kryerjes së kontrollit.

PJESA V
MBISHKRIMET DHE SHENJAT E VENDOSURA MBI SHISHET ENËMATËSE

5. Rregullat për vendosjen e mbishkrimeve në shishe enëmatëse

5.1 Shisheet enëmatëse do të mbajnë mbishkrime si parashikohen në nenin 36 pika 2 të ligjit për metrologjinë.

5.2 Të gjitha mbishkrimet mbi shishe enëmatëse duhet të vendosen në mënyrë që të mos shuhet, lehtësisht të lexueshme dhe të dukshme në kushte normale të paraqitjes.

5.3 Një shishe enëmatëse do të mbajë në një anë të saj, në fund ose në rrethin e fundit:

a) një mbishkrim tregues për kapacitetin nominal të saj në germa:

1. të paktën 6 mm të larta, nëse kapaciteti nominal është më i madh se 100 cl;

2. 4 mm të larta në qoftë se është nga 100 cl e poshtë deri 20 cl (pa përfshirë atë);

3. 3 mm të larta në qoftë se ai nuk është më i madh se 20 cl, të ndjekur nga simboli i njësisë së matjes së përdorur;

b) shenjën e identifikimit të prodhuesit;

c) shenjën “s” që vërteton që kapaciteti aktual i një shisheje enëmatëse plotëson kërkesat e specifikuara. Ajo duhet të ketë të paktën 3 mm lartësi dhe të ketë formën, paraqitja grafike e të cilës jepet në aneksin 3.

5.4 Një shishe enëmatëse do të mbajë në fund ose në rrethin e fundit në përputhje me metodën ose metodat e mbushjes për të cilën është ideuar:

a) një mbishkrim tregues për kapacitetin “deri në buzë” të shprehur në centilitra dhe të pandjekura nga simboli cl. Madhësia e mbishkrimit duhet të jetë e njëjtë me madhësinë e mbishkrimit për kapacitetin nominal.

b) dhe/ose një mbishkrim tregues në milimetra të distancës nga niveli “deri në buzë” deri te niveli i mbushjes që i përket kapacitetit nominal, i ndjekur nga simboli mm.

5.5 Treguesit që i referohen pikës 5.3 do të fiksohen në germa me lartësinë e specifikuar në pikën 5.3 a në mënyrë tillë që të mos krijojnë konfuzion me treguesit e pikës 5.4.

5.6 Kapaciteti nominal i një shisheje enëmatëse do të shprehet:

a) në litra, nëse është më i madh ose i barabartë me 1 litër;

b) në mililitra, ose centilitra, nëse është më i vogël se 1 litër.

5.7 Tregues të tjerë mund të paraqiten në shishe enëmatëse, por ato nuk duhet të krijojnë konfuzion me treguesit e referuar pikave 5.3 dhe 5.4.

5.8 Forma dhe paraqitja grafike e shenjës së konformitetit të kapacitetit aktual të shisheve enëmatëse duhet të jetë konform aneksit 3.

Aneksi nr.1

GABIMET MAKSIMALE TË LEJUARA

Kapaciteti nominal (V_n/V_r) në mililitra	Gabimi maksimal i lejuar	
	në % të V_n/V_r	në ml
nga 50 deri 100	-	3
nga 100 deri 200	3	-
nga 200 deri 300	-	6
nga 300 deri 500	2	-
nga 500 deri 1000	-	10
nga 1000 deri 5000	1	-

-Vlerat e gabimeve maksimale të lejuara të treguara në tabelë në përqindje, në qoftë se llogariten në njësi të volumit, do të rrumbullakosen deri te një e dhjeta e mililitrit më të afërt.

-“Gabimi maksimal i lejuar” është devijimi (shmangia) maksimale që për kapacitetin aktual të

shishes lejohet të jetë ndryshe nga kapaciteti nominal i treguar.

Aneksi nr.2

METODA REFERUESE PËR KONTROLLIN STATISTIKOR ME MOSTRA TË KAPACITETIT AKTUAL TË SHISHEVE ENËMATËSE

Partia e inspektuar duhet të përfshijë shishe enëmatëse të të njëjtit disaini dhe përmasë, kapaciteti nominal, materiali dhe prodhimi.

Madhësia e partisë së inspektuar do të përcaktohet në bazë të prodhimit orar.

Një mostër çfarëdo (e rastësishme) do të merret nga partia dhe kapaciteti aktual i çdo shisheje enëmatëse do të matet.

Kapaciteti aktual do të matet me peshim në 20 °C.

Shishet enëmatëse do të peshohen bosh, pastaj të mbushura me ujë me densitet të njohur në 20°C, deri në nivelin e mbushjes përkatësisht me metodën e kontrollit të përdorur.

Mesatarja e kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse të matura do të llogaritet dhe pastaj të vlerësohet me një nga metodat statistikore në vijim:

1. metodën e devijimit standard;

2. metoda e diapazonit mesatar.

Numri i shisheve enëmatëse që përbën mostrën do jetë 35 ose 40, në varësi të metodës së zgjedhur si më sipër.

Nëse rezultati i kontrollit të një partie që i korrespondon prodhimit orar nuk është i kënaqshëm, mund të kryhet një test i dytë i bazuar në një mostër tjetër të zgjedhur prej një partie që i korrespondon një periudhe kohe më të gjatë prodhimi ose mund të kontrollohen rezultatet e regjistrimeve të kartave të kontrollit të prodhuesit.

Kontrolli i kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse, në bazë të vlerësimit të mesatares së kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse në një mostër, duke përdorur metodën e devijimit standard.

Merret një mostër çfarëdo prej 35 shishesh enëmatëse. Kapacitetet aktuale x_i të shisheve enëmatëse në mostër do të maten të gjitha.

Llogaritni si vijon:

1. vlerën mesatare $\bar{x}$ të kapaciteteve aktuale x_i të shisheve enëmatëse në një mostër;

2. devijimin standard "s";

3. kufirin e sipërm të lejuar T_s të kapacitetit aktual;

4. kufirin e poshtëm të lejuar T_i të kapacitetit aktual.

Partia do të deklarohet që plotëson kërkesat ndaj kapacitetit aktual, nëse ajo plotëson njëkohësisht tri kriteret e pranimi që vijnë:

$$\bar{x} + k \cdot s \leq T_s \quad (1)$$

$$\bar{x} - k \cdot s \geq T_i \quad (2)$$

$$s \leq F(T_s - T_i) \quad (3)$$

ku: $k = 1,57$

$F = 0,266$

Llogaritjet

1. Vlera mesatare $\bar{x}$ e kapaciteteve aktuale x_i e shisheve enëmatëse në një mostër
Llogaritni si vijon:

- Shuma e matjeve të kapacitetit aktual x_i sipas formulës $\bar{x} = \sum x_i$

- Vlera mesatare $\bar{x}$ e kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse sipas formulës:

$$\bar{x} = \frac{\sum x_i}{35}$$

2. Devijimi standard “s”

Devijimi standard i vlerësuar llogaritet me formulën:

$$s = \sqrt{\frac{1}{n-1} \cdot \sum_{i=1}^n (\bar{x}_i - \bar{x})^2}$$

3. Kufiri i sipërm i lejuar T_s i kapacitetit aktual

Llogaritet si shuma e kapacitetit të treguar dhe gabimit maksimal të lejuar që i korrespondon këtij kapaciteti.

4. Kufiri më i ulët i lejuar T_i i kapacitetit aktual

Llogaritet si diferenca ndërmjet kapacitetit të treguar dhe gabimit maksimal të lejuar që i korrespondon këtij kapaciteti.

Kontrolli i kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse në bazë të vlerësimit të mesatares së kapaciteteve aktuale të shisheve në një mostër, duke përdorur metodën e diapazonit mesatar

Merret një mostër çfarëdo prej 40 shishesh enëmatëse. Do të maten kapacitetet aktuale x_i të shisheve enëmatëse në mostër.

Llogaritet si vijon:

1. Vlerën mesatare të kapaciteteve aktuale x_i të shisheve enëmatëse në një mostër;

2. Diapazonin mesatar $\bar{R}$ të kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse në një mostër;

3. Kufirin e sipërm të lejuar T_s të kapacitetit aktual;

4. Kufirin e poshtëm të lejuar T_i të kapacitetit aktual.

Partia do të deklarohet që plotëson kërkesat ndaj kapacitetit aktual, nëse ajo përmbush njëkohësisht të tri kërkesat e pranimit që vijnë:

$$\bar{x} + k \cdot \bar{R} \leq T_s \quad (1)$$

$$\bar{x} - k \cdot \bar{R} \geq T_i \quad (2)$$

$$\bar{R} \leq F \cdot (T_s - T_i) \quad (3)$$

ku:

$$k = 0,668$$

$$F = 0,628$$

Llogaritjet

1. Vlera mesatare $\bar{x}$ e kapaciteteve aktuale x_i të shisheve enëmatëse në një mostër

Llogaritet si vijon:

Shumën e matjeve të kapaciteteve aktuale x_i sipas formulës $\bar{x} = \frac{\sum x_i}{n}$

Vlerën mesatare $\bar{x}$ të kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse sipas formulës

$$\bar{x} = \frac{\sum x_i}{40}$$

2. Rangun (diapazonin) mesatar $\bar{R}$ të kapaciteteve aktuale të shisheve enëmatëse në një mostër.

Ndani mostrën, sipas radhës kronologjike të zgjedhjes, në tetë nënmostra prej pesë shishesh enëmatëse secila.

Llogaritet si vijon:

- Diapazoni i secilës nënmostër, d.m.th. diferenca midis kapacitetit aktual më të madh dhe më të vogël të pesë shisheve enë në nënmostër; kështu merren tetë diapazone : $R_1, R_2, R_3 \dots R_8$;

- Shuma diapazoneve e tetë nënmostrave: $\sum R = R_1 + R_2 + R_3 + \dots + R_8$

- Diapazoni mesatar $\bar{R}$ llogaritet me formulën : $\bar{R} = \frac{\sum R_i}{8}$

3. Kufiri më i lartë i lejuar T_s i kapacitetit aktual

Llogaritet si shuma e kapacitetit të treguar me gabimin maksimal të lejuar që i korrespondon këtij kapaciteti.

4. Kufiri më i ulët i lejuar T_i i kapacitetit aktual

Llogaritet si diferenca ndërmjet kapacitetit të treguar dhe gabimit maksimal të lejuar që i korrespondon këtij kapaciteti.

Aneksi nr.3

SHENJA E KONFORMITETIT

A. SHENJA SHQIPTARE “S” E KONFORMITETIT TË KAPACITETEVE AKTUALE TË SHISHEVE ME KËRKESAT E SPECIFIKUARA

S

Paraqitja grafike e formës do të jetë germa “s” të alfabetit shqiptar me përmasat: gjerësia sa (0.7 - 0.8) e lartësisë.

B. SHENJA EUROPIANE “3” E KONFORMITETIT TË KAPACITETEVE AKTUALE TË SHISHEVE ME KËRKESAT E SPECIFIKUARA

3

Shenja është një shkronjë “Epsilon”, simetrikisht e rrotulluar në aksin vertikal.

VENDIM
Nr.1162, datë 13.8.2008

PËR NJËSITË E TJERA TË MATJES JASHTË SISTEMIT SI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministritë, institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor, personat fizikë, juridikë, që ushtrojnë aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë, detyrohen të përdorin njësitë ligjore të matjes. Njësitë ligjore të matjes janë njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar SI, dhe ato jashtë sistemit SI të paraqitura në tabelën 6, 7 dhe 8 të këtij vendimi.

2. Në transportin ajror, detar dhe hekurudhor, krahas njësive të sistemit SI të paraqitura në këtë vendim, lejohen të përdoren edhe njësi të tjera të përcaktuara në konventa apo marrëveshje ndërkombëtare të këtyre llojeve të transporteve.

3. Njësitë bazë të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI janë:

3.1 Për gjatësinë: metri (m), i cili është i barabartë me gjatësinë e largësisë së përshkruar nga drita në boshllëk gjatë një kohe prej $1/299\,792\,458$ të sekondës.

3.2 Për masën: kilogrami (kg), i cili është e barabartë me masën e prototipit ndërkombëtar të kilogramit.

3.3 Për kohën: sekonda (s), e cila është i barabartë me kohëzgjatjen e $9\,192\,631\,770$ periodave të rrezatimit, që i përgjigjet kalimit ndërmjet dy niveleve superfundore të gjendjes themelore të atomit të Ceziumit ^{133}Cs .

3.4 Për intensitetin e rrymës elektrike: amperi (A), i cili është i barabartë me intensitetin e një rryme të pandryshueshme, që, duke kaluar nëpër dy përcjellës drejtvizorë e paralelë, me gjatësi të pafundme, e prerje tërthore të papërfillshme dhe të vendosur në një largësi 1 m në boshllëk, bën që të bashkëveprojnë ndërmjet tyre me një forcë prej $2\cdot 10^{-7}$ njuton për çdo metër gjatësi.

3.5 Për temperaturën termodinamike: kelvin (K), i cili është i barabartë me $1/273,16$ -tën pjesë të temperaturës termodinamike të pikës trefishe të ujit. Përkufizimi i K-së i referohet ujit që ka këtë përbërje specifike izotopike:

- 0.00015576 mol ^2H për një mol të ^1H ,
- 0.0003799 mole ^{17}O për një mol ^{16}O dhe
- 0.0020052 mol të ^{18}O për një mol ^{16}O

sipas përbërjes së materialit referues (mesatarja standarde e Vjenës për ujin e oqeanit) të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike.

3.6 Për sasinë e lëndës: mol (mol), i cili është i barabartë me sasinë e lëndës së një sistemi që përmban aq njësi elementare sa atome ka në $0,012$ kg të lëndës së karbonit ^{12}C .

Kur përdoret moli, njësitë elementare duhet të specifikohen, sepse ato mund të jenë atome, molekula, elektrone, pjesëza të tjera ose grupime të specifikuara të këtyre pjesëzave.

3.7 Për intensitetin e dritës: kandela (cd), e cila është e barabartë me intensitetin e dritës së një burimi, që lëshon në një drejtim të dhënë një rrezatim njëngjyrësh me frekuencë $540\cdot 10^{12}$ herz dhe me një intensitet energjetik $1/683$ wat për steradian në këtë drejtim.

4. Madhësia, emri dhe simboli i njësive bazë SI jepen në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI.

Njësitë e rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI formohen nga njësitë bazë nëpërmjet shprehjeve algjebrike që lidhin madhësitë korresponduese.

5.1 Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI, të cilat shprehen vetëm nga njësitë bazë të këtij sistemi matjeje jepen në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5.2 Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI, të cilat shprehen me emra dhe simbole të veçanta jepen në tabelën nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5.3 Madhësia, emri dhe simboli i njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI, të cilët shprehen nga kombinimi i disa njësive të rrjedhura të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI me ata me emra dhe simbole të veçanta, jepen në tabelën nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Sistemi Ndërkombëtar i Matjeve SI shpreh shumëfishat dhe nënfishat dhjetorë të njësive të matjeve me ndihmën e parashtesave. Faktori i fuqisë, emri dhe simboli i parashtesave të njësive të matjes të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI jepen në tabelën nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Emri, simboli dhe vlera në njësi SI i njësive të pranuar për t'u përdorur me Sistemin Ndërkombëtar të Matjeve SI jepen në tabelën nr.6, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Emri, simboli, përkufizimi dhe vlera në njësi SI i njësive matëse të pranuar për t'u përdorur me Sistemin Ndërkombëtar të Matjeve SI, vlera e të cilave është përcaktuar në mënyrë eksperimentale, jepen në tabelën nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Emri, simboli dhe vlera në njësi SI i njësive të tjera të pranuar për t'u përdorur me Sistemin Ndërkombëtar të Matjeve SI jepen në tabelën nr.8, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Rregullat për përdorimin e drejtë të njësive të matjes të Sistemit Ndërkombëtar të Matjeve SI janë:

10.1 Çdo madhësi në sistemin ndërkombëtar SI ka një njësi të vetme, kurse e anasjella nuk është e vërtetë.

10.2 Vlerat e madhësive të quajtura pa përmasa shprehen vetëm me numra dhe paraqesin raportin e dy madhësive të së njëjtës natyrë.

10.3 Simbolet e njësive shkruhen me shkronja latine dhe në përgjithësi të vogla. Në rastet kur emri i njësisë rrjedh nga një emër i përveçëm, shkronja e parë e simbolit shkruhet me shkronjë të madhe.

10.4 Emri i plotë i një njësie shkruhet me shkronjë të vogël.

10.5 Simbolet e njësive mbeten të pandryshuara, kur vlera e madhësisë ndryshon nga njësia.

10.6 Simbolet e njësive nuk ndiqen me pikë pas tyre, me përjashtim të rasteve kur ndodhen në fund të fjalisë.

10.7 Nëse një njësi shoqërohet me madhësi relative, duhet që ajo të tregohet vetëm me simbolin e vendosur prapa vlerës numerike.

10.8 Produkti i dy ose më shumë njësive shënohet me njërën nga mënyrat e mëposhtme: N.m ose N m.

10.9 Kur një njësi e rrjedhur formohet nga pjesëtimi i dy njësive, përdoret një vijë e pjerrët (/), një vijë horizontale ose eksponente negative.

10.10 Asnjëherë nuk përdoret në një rresht më shumë se një vijë e pjerrët, me përjashtim të rastit kur janë vendosur kllapat.

10.11 Shumëfishat dhe nënfishat e njësisë së masës formohen nga bashkimi i parashtesave me fjalën "gram", simboli i të cilit është "g".

10.12 Simbolet e parashtesave shkruhen me shkronja latine pa hapësirë ndërmjet simbolit të parashtesës dhe simbolit të njësisë.

10.13 Nuk lejohet të përdoren parashtesa të përbëra, të formuara nga vendosja e shumë parashtesave.

10.14 Një parashtesë nuk lejohet të përdoret vetëm, pa njësinë.

10.15 Nëse simbolit të njësisë të ngritur në një fuqi i vihet një parashtesë, atëherë edhe parashtesa kuptohet që është e ngritur në atë fuqi.

10.16 Nuk lejohet zbatimi i parashtesave SI për njësitë këndore: "°, ' , °" apo për njësitë e kohës: min, h, d.

11. Vendimi nr.431, datë 26.6.2003 i Këshillit të Ministrave "Për njësitë ligjore të matjes" dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1.
NJËSITË BAZË SI

Njësi bazë të SI

Madhësia	Emri i njësisë	Simboli
- gjatësia	metër	m
- masa	kilogram	kg
- koha	sekond	s
- rryma elektrike	amper	A
- temperaturë termodinamike	kelvin	K
- sasia e lëndës	mol	mol
- intensiteti i dritës	kandela	cd

Tabela nr.1.1 Emër dhe imbol i veçantë i njësisë së temperaturës për shprehjen e temperaturës në Celcius

Madhësia	Njësia	
	Emri	Simboli
Temperatura celcius	Celcius	$^{\circ}\text{C}$

Temperatura Celcius është përcaktuar si diferencë $t = T - T_0$ ndërmjet dy temperaturave termodinamike T dhe T_0 , ku $T_0 = 273,15 \text{ K}$. Një interval ose diferencë temperaturash mund të shprehet në kelvin ose në gradë celcius.

Tabela nr.2

NJËSI TË RRJEDHURA NGA NJËSITË BAZË TË SISTEMIT SI

Njësi e rrjedhur të SI

Madhësia e rrjedhur	Njësia e rrjedhur	Simboli
- sipërfaqja	metri katror	m^2
- vëllimi	metër kub (a)	m^3
- shpejtësia	metër për sekondë	m/s
- nxitimi	metër për sekondë në katror	m/s^2
- numri i valëve	një për metër	m^{-1}
- densiteti	kilogram për metër kub	kg/m^3
- volumi specifik	metër kub për kilogram	m^3/kg
- densiteti i rrymës	amper për metër katror	A/m^2
- intensiteti i fushës magnetike	amper për metër	A/m
- përqendrimi (i sasisë së lëndës)	mol për metër kub	mol/m^3
- shkëlqimi	candela për metër katror	cd/m^2
- indeksi i thyerjes	një (numër)	1
- aktiviteti katalitik	katal	$\text{kat}=\text{mol/s}$

(a) Simboli “1” zakonisht nuk përdoret në kombinime me vlerën numerike.

Njësitë e rrjedhura koherente formohen nga shprehjet algjebrike që përmbajnë veprime të shumëzimit dhe të ngritjes në fuqi të njësive bazë SI dhe të shumëzuara këto me një koeficient të barabartë me 1.

Tabela nr.3

NJËSI TË RRJEDHURA TË SI, ME EMRA DHE SIMBOLE TË VEÇANTA

Madhësia e rrjedhur	Emri	Simboli	E shprehur në njësi të tjera të SI	E shprehur në njësi bazë të SI
- këndi plan	radian ^(a)	rad		$m \cdot m^{-1} = 1(b)$
- këndi në hapësirë	steradian	sr		$m^2 \cdot m^{-2} = 1(b)$
- frekuencë	herz	Hz		s^{-1}
- forcë	Njuton	N		$m \cdot kg \cdot s^{-2}$
- presion	paskal	Pa	N/m^2	$m^{-1} \cdot kg \cdot s^{-2}$
- energji, pune, xhaul	J	N. m		$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2}$
- fuqia, fluksi energjetik wat	W	J/s		$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3}$
- ngarkesa elektrike,	culon	C		$s \cdot A$
- diferenca e potencialit	volt	V	W/A	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3} \cdot A^{-1}$
- elektrik, forca elektromotore				
- kapaciteti	farad	F	C/V	$m^{-2} \cdot kg^{-1} \cdot s^4 \cdot A^2$
- rezistenca elektrike	ohm	Ω	V/A	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-3} \cdot A^{-2}$
- përcjellshmëria elektrike	siemens	S	A/V	$m^{-2} \cdot kg^{-1} \cdot s^3 \cdot A^2$
- fluksi magnetik	weber	Wb	$V \cdot s$	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-1}$
- induktiviteti	henri	H	Wb/A	$m^2 \cdot kg \cdot s^{-2} \cdot A^{-2}$
- temperatura Celcius	gradë Celcius ^(c)	$^{\circ}C$		K
- fluksi i dritës	lumen	lm	$cd \cdot sr^{(d)}$	$m^2 \cdot m^{-2} \cdot cd = cd$
- ndriçimi	lukx	lx	lm/m^2	$m^2 \cdot m^{-4} \cdot cd = m^{-2} \cdot cd$
- aktiviteti (referuar nje burimi radioaktiv)	bekerel	Bq		s^{-1}
- doza e përthithur, energji specifike	grej	Gy	J/kg	$m^2 \cdot s^{-2}$
- doza ekuivalente,	sivert	Sv	J/kg	$m^2 \cdot s^{-2}$
- doza ekuivalente e ambientit				
- doza ekuivalente e drejtuar				
- doza ekuivalente personale				
- doza ekuivalente e organeve				

a) Radiani dhe steradiani duhet të përdoren për avantazhin në shprehjet e njësive të derivuara për të dalluar madhësitë e natyrave të ndryshme, por që kanë të njëjtin dimension. Disa shembuj të përdorimit të tyre në formimin e njësive të rrjedhura jepen në tabelën 4.

b) Në praktikë, simbolet rad dhe sr janë përdorur për matje këndore, njësia e rrjedhur.

c) Kjo njësi mund të përdoret e kombinuar me prefikset SI, si miligradë Celcius $m^{\circ}C$.

d) Në fotometri, emri steradian dhe simboli sr zakonisht përdoret në shprehjet e njësive.

Radian është këndi plan që formohet nga dy rreze që presin në perimetrin e një rrethi një hark të barabartë me gjatësinë e rrezes.

Steradian është këndi i ngurtë (në hapësirë) i një koni që ka kulmin në qendrën e një sfere dhe pret në sipërfaqen e saj një sipërfaqe të barabartë me atë të një katrori me brinjë të barabartë me rrezen.

Emrat e veçantë për njësinë e fuqisë elektrike: emri volt-amper (simboli “VA”) do të përdoret për të shprehur fuqinë e plotë në rrymën alternative dhe Var (simboli “var”) do të përdoret për të shprehur fuqinë reaktive në rrymë alternative.

Tabela nr.4

SHEMBUJ TË NJËSIVE TË RRJEDHURA SI, EMRAT DHE SIMBOLET E TË CILAVE SHPREHEN NGA KOMBINIMI I NJËSIVE TË RRJEDHURA TË SISTEMIT NDËRKOMBËTAR TË MATJEVE SI ME EMRA DHE SIMBOLE TË VEÇANTA

Njësi të rrjedhura të SI

Njësia e rrjedhur	Emri	Simboli	Shprehur në terma të njësive bazë të SI
- Vizkoziteti dinamik	paskal sekond	Pa.s	$\text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-1}$
- Momenti i forcës	njuton metër	N.m	$\text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-2}$
- Tensioni sipërfaqësor	njuton për metër	N/m	$\text{kg}.\text{s}^{-2}$
- Shpejtësia këndore	radian për sekondë	rad/s	$\text{m}.\text{m}^{-1}.\text{s}^{-1} = \text{s}^{-1}$
- Nxitimi këndor	radian për sekondë katror	rad/ s ²	$\text{m}.\text{m}^{-1}.\text{s}^{-1} = \text{s}^{-2}$
- Densiteti fluksit termik rrezatimi energjetik	wat për metër katror	W/.m ²	$\text{kg}.\text{s}^{-3}$
- Kapaciteti termik entropia specifike	xhaul për Kelvin	J/K	$\text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-2}.\text{K}^{-1}$
- Kapaciteti termik specifik entropia specifike	xhaul për kilogram kelvin	J/(kg.K)	$\text{m}^2.\text{s}^{-2}.\text{K}^{-1}$
- Energjia specifike	xhaul për kilogram	J/kg	$\text{m}^2.\text{s}^{-2}$
- Përcjellshmëria termike	vat për metër kelvin	W/(m.K)	$\text{m}.\text{kg}.\text{s}^{-3}.\text{K}^{-1}$
- Energjia vëllimore	xhaul për metër kub	J/ m ³	$\text{m}^{-1}.\text{kg}.\text{s}^{-2}$
- Intensiteti i fushës elektrike	volt për metër	V/m	$\text{m}.\text{kg}.\text{s}^{-1}.\text{A}^{-1}$
- Ngarkesa elektrike vëllimore	kulon për metër kub	C/ m ³	$\text{m}^{-3}.\text{s}.\text{A}$
- Induksioni elektromagnetik	kulon për metër katror	C/ m ²	$\text{m}^{-3}.\text{s}.\text{A}$
- Përcjellshmëria dielektrike	farad për metër	F/m	$\text{m}^{-3}.\text{kg}^{-1}.\text{s}^4.\text{A}^2$
- Përcjellshmëria magnetike	henri për metër	H/m	$\text{m}.\text{kg}.\text{s}^{-2}.\text{A}^{-2}$
- Energjia molare	xhaul për mol	J/m	$\text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-2}.\text{mol}^{-1}$
- Entropia molare	xhaul për mol kelvin	J/(mol.K)	$\text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-2}.\text{K}^{-1}.\text{mol}^{-1}$
- Kapaciteti termik molar			
- Ekspozimi ndaj rrezeve x dhej	kulon për kilogram	C/kg	$\text{kg}^{-1}.\text{s}.\text{A}$
- Fuqia e dozës së absorbimit	grej/s	Gy/s	$\text{m}^2.\text{s}^{-3}$
- Intensiteti i rrezatimit	vat per steradian	W/sr	$\text{m}^4.\text{m}^{-2}.\text{kg}.\text{s}^{-3}$ $= \text{m}^2.\text{kg}.\text{s}^{-3}$
- Luminishenca energjetike	vat për metër katror steradian	W(m ² .sr)	$\text{m}^2.\text{m}^{-2}.\text{kg}.\text{s}^{-3}$ $= \text{kg}.\text{s}^{-3}$

Tabela nr.5
SHUMËFISHAT DHE NËNFISHAT DHJETOR TË NJËSIVE TË MATJES TË SISTEMIT SI

Shumëfishët dhe nënfishat dhjetor të njësive formohen me anë shumëzimit të faktorëve numerik dhjetorë, me njësi të “SI”.

Faktorët numerikë tregohen me prefikse ose simbole të tyre, që vendosen para emrit të njësisë ose simbolit të tyre.

Faktori	Prefiksi	Simboli
10 ²⁴	jota	Y
10 ²¹	zeta	Z
10 ¹⁸	eksa	E

10^{15}	peta	P
10^{12}	tera	T
10^9	giga	G
10^6	mega	M
10^3	kilo	k
10^2	hekto	h
10	deka	da
10^{-1}	deci	d
10^{-2}	centi	c
10^{-3}	mili	m
10^{-6}	mikro	μ
10^{-9}	nano	n
10^{-12}	piko	p
10^{-15}	femto	f
10^{-18}	ato	a
10^{-21}	zepto	z
10^{-24}	yokto	y

Tabela nr.6
NJËSI JO TË SI, QË PRANOHEM TË PËRDOREN ME SISTEMIN NDËRKOMBËTAR TË NJËSIVE

Emri	Simboli	Vlera në njësi të SI
minutë	min	1 min = 60 s
orë	h	1 h = 60 min = 3 600 s
ditë	d	1 d = 24 h = 86 400 s
perimetër rrethi (*)		(*) = 2π rad
gradë	o	1 o = $(\pi/180)$ rad
minutë	'	1' = $(1/60)$ o = $(\pi/10 800)$ rad
sekondë	''	1'' = $(1/60)'$ = $(\pi/648 000)$ rad
litër	l, L	1 l = $1 \text{ dm}^3 = 10^{-3} \text{ m}^3$
ton	t	1 t = 103 kg
nëpër	Np	1 Np = 1
bel	B	1 B = $(1/2) \ln 10$ (Np)

(*) – nuk ekziston asnjë simbol për perimetrin e rrethit.

Shënim. Prefikset e paraqitura në tabelën 5 do të përdoren me njësitë dhe simbolet e masës, të volumit, të presionit në ajër e lëngje dhe të njësive gradë të këndit plan të tabelës nr.6, me përjashtim të simbolit “g”.

Tabela nr.7
NJËSI JO “SI” QË PRANOHEM TË PËRDOREN ME SISTEMIN NDËRKOMBËTAR, VLERA E TË CILAVE NË KËTË SISTEM ËSHTË PËRFUTUAR EKSPERIMENTALISHT

Emri	Simboli	Përkufizimi	Vlerë në njësi të SI
- elektronvolt	eV	(a)	1 eV = $1,602 177 33 (49) \times 10^{-19} \text{ J}$
- njësia e masës atomike të unifikuar	u	(b)	1 u = $1,660540 2 (10) \times 10^{-27} \text{ kg}$

(a) Elektronvolt është energjia e marrë nga një elektron gjatë kalimit në një fushë elektrike me diferencë potenciale prej 1V, në vakum.

(b) Njësia e masës atomike të unifikuar është e barabartë me 1/12 e masës së një atomi

unbound të nuklidit ^{12}C , at rest, dhe në gjendjen bazë të tij. Në fushën e biokimisë, njësia e masës atomike e unifikuar gjithashtu emërtohet edhe dalton, simboli Da.

^(c) Njësia astronomike është njësi e gjatësisë afërsisht e barabartë me distancën mesatare tokë-diell. Vlera e saj është e tillë që, kur përdoret për të përshkruar zhvendosjen e trupave në sistemin diellor, konstantja e gravitacionit heliocentrik është $(0,017\ 202\ 098\ 95)^2\ \text{ua}^3\cdot\text{d}^{-2}$

Tabela nr.8

NJËSI TË TJERA JASHTË SISTEMIT SI, TË PRANUARA PËR T’U PËRDORUR ME SISTEMIN NDËRKOMBËTAR

Madhësia	Njësia		
	Emri	Simboli	Vlera
Sipërfaqe trualli	ar	a	1 a = 102 m ²
	hektar	ha	1 ha = 1000 m ²
Masa për njësi gjatësie në tekstil	tex	tex	1 tex = 10 ⁻⁶ kg · m ⁻¹
Vegjenca e sistemit optik	dioptri	Nuk ka simbol	1 diopter = 1 m ⁻¹
Masa e gurëve të çmuar	carat metrik	Nuk ka simbol	1 karat metrik = 2 x 10 ⁻⁴ kg
Presioni i gjakut dhe trupave të tjerë të lëngët	Milimetër kolonë zhivë	Mm Hg	1 mm Hg = 133,322 Pa
Sipërfaqja e një seksioni efektiv	Barn	b	1 b = 10 ⁻²⁸ m ²

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 2.9.2008
Doli nga shtypi më 2.9.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë